

ANALIZA VJETORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

MBI ECURINË E AKTIVITETEVE PËR VITIN 2023



TABELA E PËRMBAJTJES

SKEDA PREZANTUESE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE	4
KAPITULLI I- DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2023.....	6
Politika e Punësimit në Shifra.....	7
Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit:	7
Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës	9
Punësimi Janar- Dhjetor 2023.....	10
Programet e Nxitjes së Punësimit	11
Programet e Formimit Profesional Publik	15
Pagesa e Papunësisë.....	16
Shtetasit e huaj të punësuar në Shqipëri	17
KAPITULLI II- PUNËSIMI I DENJË NËPËRMJET SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT DHE POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS	18
Modernizimi i Shërbimit Publik të Punësimit	19
Modernizimi i infrastrukturës	21
Diversifikimi i Programeve Aktive dhe Pasive të Tregut të Punës	21
Zbatimi i politikës së Garancisë Rinore si një instrument i dedikuar për integrimin e të rinjve në tregun e punës	23
Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore	23
Modeli i Qeverisjes së Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR) në Shqipëri	23
Lançimi i Fazës Pilot.....	24
Planifikimi dhe zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit si një instrument për integrimin në tregun e punës së grupeve të disavatazuara.....	25
KAPITULLI III- ZHVILLIMI I AFTËSIVE DHE LIDHJA MË E MIRË E KËRKESËS ME OFERTËN E TREGUT TË PUNËS PËR MË SHUMË PUNËSIM, NËPËRMJET OFRIMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR.....	26
Zbatimi i planit të Optimizimit	27
Përmirësimi i infrastrukturës së IOAFP-ve.....	28
Rritja e pjesëmarrjes në AFP (Viti i Aftësive).....	31
Iniciativa në kuadër të fuqizimit dhe ndërkombëtarizimit të shkollave profesionale	34
Programi i formimit profesional.....	35
Zbatimi i kurrikulës për Aftësi Digjitale për pu.pa.	35
Zbatimi i Programit të Formimit Profesional nëpërmjet Mbështetjes Financiare me qëllim përfshirjen e të paktën 1000 punëkërkuesve	35

Diversifikimi i Ofertës në AFP në Përputhje me Nevojat e Tregut të Punës	36
Licencimi dhe monitorimi i ofruesve privatë të AFP-së.....	40
Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara	42
Realizimi i takimeve rajonale me biznesin	43
Integrimi në tregun e punës i përfituesve të Ndihmës Ekonomike	43
Trajtimi i personave PAK dhe operacionalizimi i Fondit Social	44
Analizat e Tregut të Punës	45
KAPITULLI IV- FUQIZIMI INSTITUCIONAL	47
Ristrukturimi i AKPA-s dhe institucioneve të varësisë	47
Plani i Integritetit	47
Planifikimi dhe instrumentet e monitorimit të brendshëm institucional.....	47
Karta e Performancës dhe Treguesit e Monitorueshëm	48
Treguesit e Monitorueshëm për Drejtoritë Rajonale të AKPA	48
Treguesit e Monitorueshëm për DROFPP-të	48
Treguesit e Monitorueshëm për Arsimin Profesional	49
KAPITULLI V- TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	52
Panairi i Punës dhe i Aftësive 2022	53
Publikimi i Vendeve të Lira të Punës dhe Sigurimi i Informacionit.....	53
Promovimi i Rasteve të Suksessit.....	54
Menaxhimi i Sistemit të Kërkesave për Informacion dhe i Ankesave.....	54
KAPITULLI VI- BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT SOCIAL, PROJEKTET DHE DONATORËT	56
Forcimi i Bashkëpunimit me Partnerët Social	57
Projektet dhe bashkëpunëtorët	58

SKEDA PREZANTUESE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është një institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive. AKPA është krijuar dhe ushtron veprimtarinë administrative në bazë të Ligjit nr. 15/2019, “Për Nxitjen e Punësimit”, Ligjit Nr. 15/2017, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Vendimit Nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është institucion publik, i cili ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me:

- Ligjin Nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”,
- Ligjin Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”,
- Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar,
- VKM Nr. 554, datë 31.7.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”,
- Urdhrin e Kryeministrit Nr. 164 datë 05.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”.

Misioni i AKPA-së është të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi të huaj, që kanë përfituar statusin e refugjatit si dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t’u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

Objektivat e AKPA-së përcaktohen përmes dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, ku përkatësisht institucioni angazhohet në përmbushjen e 2 qëllimeve kryesore:

- 1- Zhvillimin e aftësive dhe lidhjen më të mirë të kërkesës me ofertën e tregut të punës për më shumë punësim.

Objektivi strategjik 1.1: Reduktimi i mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet

Objektivi strategjik 1.2: Rritja e nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune

Objektivi strategjik 1.3: Funksionimi më i mirë i tregut të punës për të gjithë

- 2- Mundësimin e punësimit të denjë për gra dhe burra nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës

Objektivi strategjik 2.1: Ndërmjetësimi dhe lëvrimi i programeve mbështetëse për punësim efektiv dhe gjithëpërfshirës

Objektivi strategjik 2.2: Sigurimi i punës së denjë për të gjithë dhe kudo

Në rrafshin institucional, AKPA ka këto përgjegjësi funksionale:

- Të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit;
- Të organizojë punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;
- Të organizojë punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
- Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e drejtorive rajonale, të zyrave vendore dhe të ofruesve publikë të arsimit profesional;
- Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organizimi institucional:

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve të punësimit, të vetëpunësimit dhe të arsimit e formimit profesional, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe zhvillimin e aftësive. AKPA shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet:

- në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale;
- në nivel vendor, nëpërmjet zyrave vendore.

Skema e Organizimit institucional:

- Drejtoria Qendrore;
- 12 Drejtori Rajonale Punësimi;
- 40 Zyra Vendore Punësimi;
- 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik;
- 31 Shkolla Profesionale.

Me Ligjin Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në programin “Tregu i Punës” për vitin 2023 i janë akorduar fonde buxhetore në shumën **2,434,006** lekë.

Kapitulli I

DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2023



KAPITULLI I- DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2023

Konteksti ekonomik dhe social

Sipas të dhënave të Anketës së Forcës së Punës në 3 muajorin e III 2023, për popullsinë (15-64) vjeç:

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 76.1 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur me 2.7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm të vitit 2023 ky tregues ka pësuar një rritje prej 0.3 pikë përqindje.


Shkalla e punësimit është 67.7%. Gjatë këtij tremujori, në terma vjetorë punësimi shfaqti një tendencë rritje krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2022, prej 2.3%. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2023, punësimi pësoi një rënie prej 0.3 pikë përqindje.

Shkalla e papunësisë është 11%. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2022, shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç, pësoi një rritje prej 0.2 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e dytë 2023, shkalla e papunësisë pësoi një rënie prej 0.1 pikë përqindje.



Politika e Punësimit në Shifra

Seksioni i mëposhtëm paraqet një analizë përshkruese të të dhënave statistikore që pasqyrojnë rezultatet kryesore të aktivitetit të Zyrave të Punës për periudhën janar - dhjetor 2023.

Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit:



Gjatë vitit 2023 numri mesatar mujor (stoku) i pu.pa-ve të regjistruar në Zyrat e Punës, ishte 76,580 individë. Vihet re se, një pjesë e konsiderueshme e regjistrimit të Pu.Pa-ve përbëhet nga persona të cilët përfshihen në një ose më shumë grupe të veçanta.



Procesi i integrimit të pu.pa-ve në tregun e punës has pengesa të ndryshme lidhur me aftësitë, moshën, statusin social etj. Si rezultat rreth 95% e punëkërkuësve të papunë identifikohen në nivelin e dytë dhe të tretë të punësueshmërisë.

Duke e analizuar regjistrin e pu.pa-ve sipas moshës dhe arsimit, vihet re se rreth 46% e totalit të pu.pa-ve janë mbi 45 vjeçar dhe 54% me arsim deri 9 vjeçar, çka e vështirëson integrimin e këtyre pu.pa-ve në tregun e punës. Kjo tendencë është më e theksuar në grupet e veçanta.

Punëkërkuësit e papunë të regjistruar sipas arsimit

Totali	pa arsim	Arsim fillor (4 ose 6 vjeçar)	Arsim i mesëm i ulët (9 vjeçar)	Arsim i mesëm i Lartë (Gjimnaz)	Arsim i mesëm i lartë (Profesional)	Bachelor (3 vjeçar)	Master profesional (3+1.5) vjet	Master shkencor (3+2) vjet
76,580	2,911	2,883	35,940	23,112	4,983	3,958	1,531	1,262

Në arsimin deri 9 vjeçar përfshihen 95% e romëve, 89% e egjiptianëve, 71% e përfituesve të ndihmës ekonomike dhe 70% e pu.pa-ve PAK të regjistruar.

Punëkërkesit e papunë të regjistruar sipas Grupmoshës

Totali	15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50
76,580	2,169	8,280	7,548	7,860	7,677	8,191	9,947	24,908

Kategoritë vulnerabël karakterizohen nga një grupmoshë relativisht e re. Në grupmoshën 15-40 vjeç përfshihen 72% e romëve, 47% e egjiptianëve, 53% e pu.pa-ve PAK dhe 39% e përfituesve të ndihmës ekonomike të regjistruar në Zyrat e Punës.

Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023 u shpallën 61,173 vende të lira pune ose 54% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rreth 74% e VLP- ve të shpallura janë vende të reja pune dhe pjesa tjetër e VLP-ve janë zëvendësime.

Gjatë vitit 2023 rezultoi se 9,742 subjekte unike kanë shpallur VLP në Zyrat e Punësimit. Rajonet me numrin më të lartë të subjekteve që kanë shpallur VLP janë Tirana, Durrësi, Korça dhe Vlora përkatësisht 43%, 12%, 7% dhe 7%.

Rreth 62% e VLP-ve janë shpallur në rajonet Tiranë, Durrës dhe Fier. Rajonet Dibër, Kukës dhe Berat rezultojnë me numrin më të ulët të VLP-ve të shpallura.

DRAKPA	VLP të shpallura (%)
DR AKPA Berat	2%
DR AKPA Dibër	3%
DR AKPA Durrës	15%
DR AKPA Elbasan	6%
DR AKPA Fier	8%
DR AKPA Gjirokastrë	4%
DR AKPA Korçë	5%
DR AKPA Kukës	1%
DR AKPA Lezhë	4%
DR AKPA Shkodër	7%
DR AKPA Tiranë	39%
DR AKPA Vlorë	6%

Sektorët ekonomik të cilët shpallën më shumë VLP ishin industria përpunuese, tregtia me shumicë dhe pakicë, akomodimi dhe shërbimi ushqimor dhe ndërtimi, përkatësisht me 33.8%, 14.6%, 14.2% dhe 8.4% të VLP-ve të shpallura.

Aktivitetet ekonomike	VLP të shpallura (%)
Industria Përpunuese	33.8%
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	14.6%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	14.2%
Ndërtimi	8.4%
Aktivitete të tjera shërbimi	4.7%
Aktivitete të tjera ekonomike	24.3%

Kategoritë profesionale më të kërkuara nga tregu, referuar të dhënave të administruara nga AKPA, për vitin 2023 ishin zejtarët dhe zanatçinjtë, profesionet elementare, punonjësit e industrisë dhe punonjësit e shitjeve dhe shërbimeve, përkatësisht me 26.1%, 22.4%, 13% dhe 18.5%.

Kategoritë profesionale	VLP të shpallura (%)
Menaxherë & Specialistë me arsim të lartë	8.0%
Teknikë dhe specialistë të mesëm	4.9%
Nëpunës	5.3%
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	18.5%
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe të peshkimit	1.4%
Zejtarë zanatçinjtë dhe profesione të lidhura me to	26.1%
Punonjës në industri	13.0%
Profesione elementare	22.4%
Forcat e armatosura	0.4%
Pa profesion	0.0%

Punësimi Janar- Dhjetor 2023

Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023 janë punësuar 27,651 punëkërkues të papunë ose 3.1% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ky tregues është realizuar në masën 102% të objektivit vjetor 2023.

Krahasuar me planin vjetor të vitit 2023:

	Objektivi 2023	Realizimi 2023	%
Ndërmjetësim	12,000	12,088	101%
Punësime të tjera pas trajtimit nga ZP	15,000	15,563	104%
Total punësimi	27,000	27,651	102%

Punësimi sipas kategorive të veçanta

Grupet vulnerabël	2022	2023
Pu.Pa, me aftësi të kufizuar	18	266
Pu.Pa, Romë/ Egjiptianë	497	1,032
Pu.Pa, nga NE	1,785	2,820

Rritja e numrit të VLP-ve të shpallura dhe fondet më të pakta në dispozicion për programet e reja të nxitjes së punësimit (si pasojë e konsumimit të fondit për shkak të të mbarturve) i orientoi punëkërkuessit e papunë të grupeve të veçanta drejt punësimit dhe kurseve të formimit profesional.

Me fokus parapërgatitjen për vënien në funksion të Fondit Social të Punësimit në Shqipëri, gjatë vitit 2023 AKPA ndërmori procesin e regjistrimit të punëkërkuessve me aftësi të kufizuar si një garanci për punëdhënësit të cilët kanë detyrimin e punësimit të tyre. Gjatë periudhës janar- dhjetor 2023, nga kjo kategori janë regjistruar nëpërmjet Zyrrave të Punës rreth 2,800 punëkërkuess të papunë dhe rreth 7,900 punëkërkuess.

Gjithashtu, u zhvilluan 5 takime me punëdhënësit të sektorve më të prekur si:

- Sektori Financiar;
- Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit;
- Sektori i Tregtisë;
- Sektori i Ndërtimit;
- Sektori i Hoteleri Turizmit.

Si rezultat, 1 në 4 persona PAK të regjistruar si punëkërkuess të papunë në Zyrrat e Punësimit janë përfshirë në PATP. Konkretisht janë punësuar 266 pu.pa, kanë marrë pjesë në programet e reja të nxitjes së punësimit 19 pu.pa dhe 119 të tjerë kanë filluar një kurs të formimit profesional.

Programet e Nxitjes së Punësimit

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga zbatimi i programeve të nxitjes për vitin 2023 kanë përfituar **897** subjekte dhe **2,635** individë, nga të cilët **724** subjekte dhe **2,221** individë janë hyrjet e vitit të kaluar (të mbarturit).

Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2023 kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkesve të papunë	Fondi i harxhuar për vitin buxhetor (në milion lekë)
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	191	405	61.6
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	125	183	16.3
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	241	633	37.6
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	0	0	0.0
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	18	51	2.8
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	46	133	6.6
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	41	995	264.3
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	235	235	59.1
TOTALI	897	2,635	448.3

Nga totali i pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2023, rreth 63% e tyre ishin vajza dhe gra dhe 39% të rinj të grupmoshës 16-29 vjeç.

	Programet e mbartura		Programet e reja		Total programe të zbatuara	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
Pjesëmarrës në PNP	2,221	100%	414	100%	2,635	100%
<i>prej tyre</i>						
Femra	1,349	61%	311	75%	1,660	63%
Të rinj 16-29 vjeç	675	30%	344	83%	1,019	39%
Në pagesë papunësie	123	6%	0	0%	123	5%
Në ndihmë ekonomike	474	21%	19	5%	493	19%
Rom/ egjiptian	191	9%	3	1%	194	7%
PAK	19	1%	21	5%	40	2%
Emigrantë të kthyer	16	1%	0	0%	16	1%

Programet e reja të nxitjes të Punësimit (përfituesit e rinj të vitit 2023)

Nisja e programeve të nxitjes së punësimit në 6 mujorin e dytë të vitit 2022 nga një numër i konsiderueshëm përfituesish rezultoi me një numër të lartë të të mbarturve për vitin 2023. Si rezultat fondet në dispozicion të programeve të reja mbetën të ulta. Gjithashtu numri i përfituesve ishte i ulët dhe i fokusuar më tepër në programet e praktikave profesionale.

Gjatë vitit 2023, programet e reja të PNP-ve të cilat u zbatuan ishin ato të VKM Nr. 17. Rreth 22% e subjekteve u përfshinë në programin e punësimit, 11% në programin e formimit në punë dhe 67% në programin e praktikave profesionale.

Rreth 42.8% e numrit të pjesëmarrësve paraqiten në rajonet Elbasan, Gjirokastrë, Fier dhe Durrës.

Lloji i programit	Nr. Projektsh	Nr. Pjesëmarrësish
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	38	42
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	19	45
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikë e punës)	116	327
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	-	-
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	-	-
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	-	-
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	-	-
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	-	-
Total	173	414

Rajonet	Nr Pjesëmarrësish	%
Berat	17	4.1%
Dibër	32	7.7%
Durrës	36	8.7%
Elbasan	51	12.3%
Fier	43	10.4%
Gjirokastrë	47	11.4%
Korçë	37	8.9%
Kukës	18	4.3%
Lezhë	34	8.2%
Shkodër	34	8.2%
Tiranë	31	7.5%
Vlorë	34	8.2%
Total	414	100.0%

Numri më i lartë i subjekteve që aplikuan për pjesëmarrje në programet e punësimit dhe formimit nëpërmjet punës, ishte në aktivitetet ekonomike:

- Tregtia me shumicë dhe me pakicë;
- Aktivitete të tjera shërbimi;
- Akomodim dhe shërbimin ushqimor;

Praktikat Profesionale u zhvilluan më tepër në subjekte të cilat kanë si aktivitet ekonomik shëndetësinë, shërbimet administrative dhe mbështetëse, arsimin dhe aktivitetet financiare.

Aktivitetet Ekonomike	V.K.M 17 (Programi 1 Punesimi)	V.K.M 17 (Programi 2 Formim nepermjet pune)	V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat ne Pune)	Total
Ind. Perpunuese -Industri te tjera perpunuese			2	2
Ind. Perpunuese -Përpunimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve te duhanit			1	1
Ind. Perpunuese -Përpunimi I tekstileve, konfeksionimi I veshjeve dhe prodhimi I lekures dhe produkteve prej lekure	3	1	0	4
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm			4	4
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	4	4	0	8
Aktivitete financiare dhe të sigurimit			10	10
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1	4	9	14
Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare	7		3	10
Aktivitete të pasurive të paluajtëshme			1	1
Aktivitete të tjera shërbimi	8	2	7	17
Arsimi			10	10
Informacioni dhe komunikacioni	2			2
Ndertim	3			3
Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale			37	37
Shërbime administrative dhe mbështetëse	3	2	30	35
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	7	6	2	15
Total subjekte pjesëmarrëse	38	19	116	173

Lloji i programit	Total	Femra	Ndihma ekonomike	Rom/egjiptian	PAK
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	10%	6%	5%	0%	90%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	11%	8%	21%	0%	0%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	79%	86%	74%	100%	10%
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	0%	0%	0%	0%	0%
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	0%	0%	0%	0%	0%
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	0%	0%	0%	0%	0%
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	0%	0%	0%	0%	0%
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	0%	0%	0%	0%	0%
	100%	100%	100%	100%	100%


Kategoritë si vajzat dhe gratë, ndihma ekonomike dhe rom/egjiptianët janë përfshirë më tepër në programin e praktikave profesionale. Punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuar kanë përfituar më tepër nga programi i punësimit (90% e pjesëmarrësve të kësaj kategorie).

Në treguesit e monitorueshëm për vitin 2023 AKPA vendosi si objektiv për Programet e Nxjitjes së Punësimit pjesëmarrjen në programet e reja të 123 punëkërkuesve të papunë, objektiv i cili arriti të realizohej në masën 337%. Arsyeja e këtij tejkalimi vjen si rezultat i nisjes së programeve të reja në muajin Maj 2022, duke mundur pjesëmarrjen e më shumë pu.pa-ve në programe (sidomos në programin e praktikave profesionale) me fondin e vënë në dispozicion.

Programet e Formimit Profesional Publik

Në periudhën janar-dhjetor 2023 kanë ndjekur kurset e formimit profesional **10,547 punëkërkues të papunë** ose rreth **14%** e totalit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i pjesëmarrësve në kurse formimi rezultoi të jetë 12% më i lartë se realizimi i vitit 2022.


Duke e analizuar sipas strukturës së kursantëve (nga totali 15,134 kursantë), rreth 70% e kursantëve ishin punëkërkues të papunë të referuar nga zyrat e punësimit, 23% ishin kursantë punësuar dhe vetëpunësuar dhe pjesa tjetër përbëhet nga të papunët jo klientë të ZP, të burgosurit dhe studentët.



Emërtimi i Q.F.P-së	Totali i të regjistruarve në kurse	Prej tyre		Totali i të certifikuarve	Prej tyre	
		Femra	Punëkërkues të papunë		Femra	Punëkërkues të papunë
DROFPP Durrës	1,923	963	1137	835	484	446
DROFPP Elbasan	1,467	586	823	895	372	501
DROFPP Fier	1,271	624	1065	840	425	703
DROFPP Gjirokastrë	871	403	621	600	285	439
DROFPP Korçë	774	384	666	380	201	325
DROFPP Levizëse	1,383	760	1242	766	440	694
DROFPP Nr.1	2,284	1244	1436	1175	659	737
DROFPP Nr.4	1,961	913	1170	1153	543	649
DROFPP Shkodër	955	538	823	572	323	496
DROFPP Vlorë	2,090	1151	1504	1551	938	1225
Qendra Shumëfunktionale Kamëz	155	119	60	141	109	52
TOTAL 1 Kurset e reja 2023	15,134	7,685	10,547	8,908	4,779	6,267
TOTAL 2 Kurset e reja+ të mbartura	19,468	9,567	13,107	12,511	6,366	8,298

Prej totalit **15,134** kursantë që janë regjistruar gjatë vitit 2023, **10,984** prej tyre e kanë përfunduar kursin po gjatë këtij viti. Ndërkohë që pjesa tjetër e kursantëve referuar periudhës së regjistrimit dhe kohëzgjatjes së kursit do ta përfundojë kursin gjatë vitit 2024. Nga **10,984** kursantë, kurset e të cilëve kanë përfunduar gjatë vitit 2023, **8,907** persona apo rreth 81 % e tyre janë certifikuar.

Kalueshmëria e kurseve të filluara dhe përfunduara gjatë 2023



Për sa i përket treguesve të formimit profesional të përcaktuar në Kartën e performancës 2023, treguesi “Totali i Pu.Pa-ve pjesëmarrës në formim profesional” është realizuar në masën 103%, ndërsa realizimi i treguesve të grupeve të veçanta është tepër pozitiv.

Formim profesional	Objektivi 2022	Realizimi 2022	% e realizimit
Pu.Pa pjesëmarrës në formim	10,200	10,547	103%
Rom/ Egjiptianë	200	228	114%
PAK	50	119	238%
Ndihmë ekonomike	700	842	120%

Pagesa e Papunësisë

Gjatë vitit 2023 rezultojnë **8,647** individë përfitues të pagesës së papunësisë, prej të cilëve **8,471** përfitues ose 98% janë hyrje dhe pjesa tjetër janë rihyrje në skemë.

Në aspektin gjinor, **5,470** përfitues ose 63% e totalit janë vajza/gra dhe **3,177** ose 37 % e totalit janë burra.

Sipas periudhës së përfitimit rreth 34% e përfituesve i përkasin periudhës 3 mujore, 30% periudhës 6 mujore, 14% periudhës 9 mujore dhe 22% periudhës 1 vjeçare.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kanë hyrë në skemë **6,674** përfitues dhe kanë dalë prej saj **4,079** përfitues. Periudhat me numrin më të lartë të hyrjeve në skemë rezultojnë muajt korrik, gusht, mars dhe nëntor përkatësisht me 16%, 13%, 10% dhe 9% të totalit të hyrjeve në skemë.

Prej totalit të daljeve nga skema rreth 69% janë për arsye të përfundimit të periudhës së përfitimit të pagesës së papunësisë dhe 31% e kanë ndërprerë përfitimin. Rreth 77% e rasteve të ndërprera janë për arsye punësimi.

Sipas aktiviteteve ekonomike rreth 58% e numrit të hyrjeve në skemë rezultojnë në aktivitetet financiare dhe të sigurimit, industrinë përpunuese, aktivitete të tjera shërbimi, tregti, akomodim dhe shërbim ushqimor.

Shtetasit e huaj të punësuar në Shqipëri

Në zbatim të Ligjit 79/2021 datë 24.06.2021, "Për të Huajt" akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka shqyrtuar dhe aprovuar on-line aplikimet e bëra nëpërmjet portalit e-albania, për shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 janë aprovuar në total **9,825** aplikime për Lejet Unike, prej të cilave **8,910** janë miratime për herë të parë. Në aspektin gjinor, **2,300** aplikime të aprovuara ose 23% e totalit janë gra dhe **7,525** ose 77 % e totalit janë burra.

Sipas tipit të miratimit rreth 81% e aplikimeve të aprovuara janë punëmarrës, 4% të vetëpunësuar, 4% vullnetarë dhe 4% me kualifikim të veçantë.

Aktivitetet ekonomike me numrin më të lartë të Lejeve Unike të aprovuara rezultojnë akomodimi dhe shërbimi ushqimor, aktivitete të tjera shërbimi, ndërtimi, tregtia dhe industria përpunuese përkatësisht 11%, 10%, 10%, 9% dhe 8% të totalit .

Me numrin më të lartë të lejeve unike të aprovuara rezultojnë shtetasit nga Turqia, Bangladeshi, India, Nepali, Italia dhe Filipinet përkatësisht 13%, 12%, 11%, 8%, 7% dhe 6% të totalit.

Kapitulli II

**PUNËSIMI I DENJË
NËPËRMJET
SHËRBIMEVE TË
PUNËSIMIT DHE
POLITIKAVE
AKTIVE TË
TREGUT TË
PUNËS**



KAPITULLI II- PUNËSIMI I DENJË NËPËRMJET SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT DHE POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS

Dinamikat e reja në popullsi po ndikojnë në tregun e punës, në nivelet kombëtare dhe rajonale. Treguesit e tregut të punës paraqesin se numri i të punësuarve po vazhdon të rritet. Vetëm gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, numri i të punësuarve u rrit me 2.3%, krahasuar me një vit më parë, me një rritje të dukshme, veçanërisht tek gratë. Ndërkaq, pjesëmarrja në forcat e punës është rritur me 2.7 % në krahasim me vitin e kaluar, treguesi që tregon se një numër më i madh i qytetarëve është aktiv në tregun e punës. Pagat mujore bruto është rritur me 16.9 % krahasuar me një vit më parë, një ndryshim që pasqyron reagimin e punëdhënësve ndaj rritjes së pagës minimale, dhe kjo rritje është reflektuar në të gjitha fashat e pagave.

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 synon punësim cilësor dhe aftësim gjatë të gjithë jetës për të gjithë. Kjo strategji parashikon që sektori privat të jetë një partner në zhvillimin e aftësive të fuqisë punëtore për rikualifikimin apo rritjen e aftësive të të punësuarve. Një nga instrumentet kryesore për të adresuar nevojat për aftësi në tregun e punës në Shqipëri janë Programet Aktive të Tregut të Punës, në mënyrë specifike shërbimet e punësimit dhe Programet e Nxitjes së Punësimit.

Modernizimi i Shërbimit Publik të Punësimit

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive gjatë vitit 2023 ka ndjekur me prioritet përmirësimin e sistemit të shërbimeve të punësimit. Në këtë kontekst, janë vlerësuar ndryshimet e nevojshme, janë skicuar idetë e reja dhe janë zhvilluar takime të njëpasnjëshme për realizimin dhe finalizimin e ndryshimeve sipas nevojave të sistemit.

Zhvillimet për përmirësimin e sistemit listohen si më poshtë:

- Zhvillime mbi ndërveprimin e sistemit të QFPP me SSH
- Finalizimi i përmirësimeve në modulën e ndërmjetësimit
- Zhvillime mbi procesin e monitorimit të aplikimeve nga web
- Draftimi i modulit të GR
- Draftimi i modulit të Nxitjes së Punësimit
- Dizajnimi dhe përmirësimi i PIP

Një tjetër element mjaft prioritar për AKPA ka qenë digjitalizimi dhe ofrimi online i shërbimeve. Gjatë vitit 2023 u krijuan apo përmirësuan shërbimet online si më poshtë:

- U ngrit shërbimi “Kërkesë për kompensim financiar të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”
- U ngrit shërbimi “Aplikim për Garancinë Rinore (Punësim, Arsim dhe Formim Profesional)”
- U aplikua për herë të parë shërbimi “Aplikim për kursin e formimit profesional me mbështetje financiare”
- U hartua shërbimi “Aplikim për pagesën e papunësisë”

➤ U hartua shërbimi i ri për “Rimbursimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit”

AKPA ka siguruar qasjen online të të gjitha shërbimeve të punësimit nëpërmjet e-Albania. Në funksion të sigurimit të aksesit të drejtpërdrejtë të shërbimeve dhe programeve të punësimit/formimit është realizuar përmirësimi i portalit puna.gov.al, duke zgjeruar gamën e informacionit e funksionaliteteve si dhe duke e kthyer faqen në një hapësirë miqësore për përdoruesit. Në fund të vitit 2023 numri i personave që aksesonin puna.gov.al arriti në rreth 14,000 persona në muaj.

Gjithashtu një tjetër proces që ka vijuar të ndiqet me prioritet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive gjatë vitit 2023 ka qenë procesi i fuqizimit të strukturave dhe burimeve njerëzore. Strukturat e AKPA parashikojnë ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, profilizimin e qartë të punonjësve, optimizimin e punës dhe ofrimin e një shërbimi adekuat për punëdhënësit dhe punëmarrësit. Të gjitha zyrat e punësimit janë riorganizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit duke u bazuar te standardizimi i proceseve të punës dhe profilizimi i punonjësve.

Në vijim të procesit të ristrukturimit institucional i cili u realizua gjatë vitit 2023, miratimi i strukturave të reja të Drejtorive Rajonale të Punësimit solli disa risi në funksionimin e Zyrave të Punës, kryesisht për rajonet Tiranë dhe Durrës. Në Tiranë u konceptua për herë të parë Sektori i Garancisë Rinore dhe Fondit Social si dhe Sektori i Punëdhënësit. Ndërkohë në të dyja rajonet u krijua Sektori i Menaxhimit të Shërbimeve të Punësimit Lëvizëse. Këto me qëllim mbulimin e programeve të reja dhe shtrirjen e shërbimeve edhe në zona të pambuluara.

Një tjetër element mjaft i rëndësishëm për zhvillimin institucional dhe që ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimeve, është trajnimi profesional i stafit. Gjatë vitit 2023, trajnimet e stafit u përqëndruan kryesisht në programet e reja që u zbatuan. Më konkretisht:

- U trajnuan të gjithë punonjësit e nxitjes dhe përgjegjësit e shërbimeve në rajone për zbatimin e programit të kodimit;
- U trajnuan përgjegjësit e programeve aktive dhe pasive në rajon për zbatimin e programit të kompensimit financiar;
- U trajnuan 30 punonjës të Rajoneve Tiranë, Shkodër dhe Vlorë për zbatimin pilot të programit të Garancisë Rinore;
- U ndërtua për herë të parë paketa e trajnimit për punonjësit e rinj dhe u trajnuan 65 punonjësit e punësuar në dy vitet e fundit.

Në funksion të sigurimit të cilësisë gjatë ofrimit të shërbimeve nga zyrat e punës, në nivel qendror janë ngritur një sërë mekanizmesh monitorimi si: monitorimi i kohës së aksesimit Sistemit të Shërbimeve të Punësimit nga të gjithë punonjësit e Zyrave të Punës, monitorimi nëpërmjet kamerave në zyrat e shërbimeve si dhe monitorimi nëpërmjet instrumentave të dedikuara i realizimit të objektivave në nivel institucional, zyre dhe punonjësi.

Modernizimi i infrastrukturës

Në vijim të investimeve të kryera në zyrat e punës Nr.1 dhe Nr.2 në Tiranë të cilat janë përshtatur sipas modeleve më bashkëkohore mbi ofrimin shërbimeve (zyra Nr.2 ndër të tjera ofron dhe aksesim të lehtë për kategorinë PAK nëpërmjet pajisjeve të përshtatura teknologjike), AKPA gjatë vitit 2023 në funksion të modernizimit të mëtejshëm të infrastrukturës ka kryer investime të tjera si:

-ka rikonstruktuar dhe hapur zyrën e re të shërbimeve në Laprakë;

-ka rikonstruktuar dhe hapur zyrën e re të shërbimeve në Dibër;

-ka rikonstruktuar zyrën e shërbimeve Pukë;

-ka hapur degën e shërbimeve të punësimit në Rrogozhinë.

Zyrat e punës në vazhdimësi nëpërmjet bashkëpunimeve me partnerët apo buxhetit të shtetit janë mbështetur nga AKPA qendrore me pajisje si, kompjutera, bazë materiale etj.

Diversifikimi i Programeve Aktive dhe Pasive të Tregut të Punës

Në kuadër të diversifikimit të programeve aktive të tregut të punës AKPA gjatë vitit 2023, ka iniciuar një sërë nismash. Kështu krahas programeve ekzistuese si programi i punësimit, praktikave profesionale, formimit në punë, vetëpunësimit dhe punëve publike në komunitet janë draftuar programe të reja si:

-Programi i riintegritit.

Programi i riintegritit është një program i ri për nxitjen e punësimit, i cili synon të adresojë nevojat e punëkërkuarve të papunë afatgjatë, që janë të papunë për mbi 6 muaj. Ky program do të trajtojë me prioritet të papunët afatgjatë, që i përkasin skemës së ndihmës ekonomike dhe gratë që jetojnë në njësi administrative ku nuk ka struktura vendore punësimi. Ky program outsourcing ka dy synime kryesore: ofrimin e shërbimeve të specializuara nga organizatat joqeveritare, si dhe mundësimin e ofrimit të shërbimeve në zona më pak të mbuluara nga shërbimet e punësimit, duke adresuar kështu kapacitetet e pamjaftueshme të zyrave vendore të punësimit.

Ky program bazohet në parimin e efektivitetit, pasi organizatat do të marrin një pagesë shtesë për individët që punësohen në përfundim të programit.

Programi do të zbatohet nga AKPA në bashkëpunim me institucione të tjera vendore dhe organizata jofitimprurëse, të cilat fokusohen në fuqizimin ekonomik të grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet ofrimit të këshillimit të specializuar për punësim, vetëpunësim, trajnim profesional dhe referim në shërbimet e punësimit dhe shërbimet sociale, duke ndihmuar përfituesit të integrohen në tregun e punës. Kjo VKM pas kalimit të fazës së marrjes së mendimeve nga institucionet përgjegjëse, është përfshirë në matricën e akteve që do të miratohen gjatë 3 muajve të parë të vitit 2024.

Programi trajnimit/të nxëniet në vendin e punës si pjesë e paketës së garancisë rinore

Në kuadër të pilotimit dhe zbatimit të këtij programi është hartuar një program i ri nxitje punësimi sipas skemës së Garancisë Rinore, të miratuar me VKM-në 264/2023 “Për Miratimin e Procedurave, Kriteve dhe Rregullave për Zbatimin e Programit të Nxitjes së Punësimit, sipas skemës së Garancisë Rinore nëpërmjet të Nxëniet në Vendin e Punës”. Ky program do të sigurojë që punëkërkuesit e papunë të trajnohen për një periudhë 3 deri 6 mujore në vendin e punës në subjektet që do të bëhen pjesë e programit. Ai do të sigurojë kostot e instruktorit në biznes dhe do të ofrojë subvencionim për përfituesit. Në përfundim të programit pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë kualifikimi.

Programi i kodimit

AKPA gjatë vitit 2023 zbatoi për herë të parë programin e kodimit. Ky program zbatohet në referim të VKM-së nr. 646, datë 5.10.2022 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private” dhe udhëzimit nr.1, datë 10.01.2023 “Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare”. Nëpërmjet këtij programi synohet ofrimi i kurseve të avancuara që përputhen me prioritetet e zhvillimit ekonomik. Prioritet ka qenë ofrimi i kurseve të fushës IT, si kodim, programim, siguri kibernetike, robotikë etj, kundrejt mbështetjes buxhetore për punëkërkuesit në masën 50% të vlerës dhe për punëkërkuesit e papunë në masën 100 % të vlerës.

Kursi më i kërkuar ishte Java me 16% të totalit të aplikimeve, pas tij Cyber Security (8%), Python Fullstack (8%), Python (6%) etj. Nëse i referohemi moshës, 81% e aplikantëve ishin 15-29 vjeç, ndjekur nga 12% e aplikantëve 30-35 vjeç dhe përqindja më e vogël prej 7% ishte e moshës mbi 36 vjeç. Rajoni kryesor me numrin më të madh të aplikantëve ishte Tirana me 58% të totalit të aplikimeve, më pas Durrësi, Korça dhe Fieri.

-Programi Kompensimit të Subjekteve

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.114, datë 01.03.2023 “Për përdorimin e fondit të kontingjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, u realizua kompensimi për çdo të punësuar me pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi.

Drejtoria e Shërbimeve të Tregut të Punës ndoqi dhe monitoroi zbatimin e këtij vendimi i cili parashikonte kompensim të subjekteve për çdo të punësuar me pagë minimale përpara hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je. Për vitin 2023, për periudhën prill- dhjetor 2023, janë kryer gjithsej 3,037 aplikime, mesatarisht 337 aplikime në muaj. Për çdo muaj janë paguar mesatarisht 12,560 punonjës.

Fondi i akorduar nga Buxheti i Shtetit në Artikullin 603 “Nxitje Punësimi” Kodi 91013AC “Kompensim Financiar” ishte 195.000.000 lekë. Fondi i shpenzuar fakt është 175.676.256 lekë.



Zbatimi i politikës së Garancisë Rinore si një instrument i dedikuar për integrimin e të rinjve në tregun e punës

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore

Në vijim të rekomandimeve të ardhura nga Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, në vitin 2021-2022 u hartua Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2023-2024 në Shqipëri. Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore në Shqipëri u dizajnuar nga Grupi Ndërinstitucional dhe me mbështetjen e Asistencës Teknike për Mbështetjen e Reformës në Politikat e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional (SREPVET) dhe më pas nga Asistenca Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Reformave në Fushat e Përfshirjes Sociale në Shqipëri (EU4SI).

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është në linjë të plotë me Pilarin Evropian për të Drejtat Sociale, si dhe Inkorporon rekomandimet e paraqitura nga Bashkimi Evropian.

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është i integruar në dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të miratuar me Vendimin nr.173, datë 24.3.2023 të Këshillit të Ministrave. Ky plan përcakton fazat dhe kontributin e institucioneve të ndryshme, për zhvillimin dhe koordinimin e politikave arsimore, të punësimit dhe ato sociale për të rinjtë, duke synuar heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive që të rinjtë të hyjnë në tregun e punës dhe të kenë një zhvillim të suksesshëm profesional.

Në zbatim të Planit të Garancisë Rinore dhe duke synuar diversifikimin e ofertave dedikuar target grupit të synuar, përkatësisht: të rinjtë 15-29 vjeç të cilët nuk janë të punësuar, nuk janë duke ndjekur një trajnim apo formim profesional dhe nuk janë duke ndjekur një cikël arsimor, u miratua një Program i ri Nxitje Punësimi “Të Nxëniet në Vendlindje të Punës, sipas Skemës së Garancisë Rinore”. Programi i ri do të realizohet me anë të kurseve 3 deri në 6-mujore të formimit profesional nëpërmjet të nxëniet në vendlindje të punës dhe më pas punësimit për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Programi do të zbatohet për herë të parë në 3 rajonet pilot (Shkodër, Vlorë, Tiranë) të Garancisë Rinore, të përcaktuara gjatë vitit 2023.

Modeli i Qeverisjes së Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR) në Shqipëri

Modeli i Qeverisjes së Garancisë Rinore është themeluar me institucionet dhe partnerët e përfshirë në këtë ndërhyrje, si institucionet shtetërore të përfshira në Skemë, por gjithashtu dhe partnerë socialë dhe grupe të interesit.

Modeli i qeverisjes i propozuar nga PZGR deri në këtë moment është nën koordinimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), si institucion përgjegjës për politikat e punësimit dhe formimit profesional. MFE koordinon një grup të gjerë institucionesh nga fusha e punësimit, formimit profesional, arsimit dhe rinisë, ndërkohë Koordinatori Kombëtar është zëvendësministri

përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Koordinatori Kombëtar është përgjegjës për monitorimin dhe raportimin në nivele të larta të qeverisjes, si dhe në Komisionin Evropian.

Koordinimi Ekzekutiv i Planit të Garancisë Rinore realizohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe siguron menaxhimin dhe koordinimin e zbatimit në territor përmes strukturave të punësimit dhe ofruesve të AFP-së, të instrumenteve të përcaktuara në të.

Për mirëqeverisjen dhe monitorimin ndërinstitucional të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore, dy Grupe Pune janë themeluar dhe janë në bord për mobilizimin e partneriteteve, në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr. 28, datë 24.02.2022. Një prej grupeve është Komiteti i Monitorimit të Skemës së Garancisë Rinore, i cili është drejtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Grupi Teknik Ndërinstitucional, i cili angazhohet për menaxhimin e diskutimeve teknike gjatë zbatimit të Skemës.

Për zbatimin e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore është parashikuar një qasje bashkëpunuese, ku janë të përfshirë shumë aktorë të fushës, përfshirë sindikatat, organizatat e rinisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, organizatat jo-qeveritare dhe njësitë administrative, midis të tjerave.

Lancimi i Fazës Pilot

Me qëllim nisjen e fazës pilot, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë realizuan planin e zbatimit të Fazës Pilot në tre bashki; përkatësisht në Bashkinë Tiranë, Vlorë dhe Shkodër. Sipas rekomandimeve të Bashkimit Evropian, për përzgjedhjen e rajoneve për pilotimin e Garancisë Rinore, indikatorët që janë analizuar dhe konsideruar janë:

- Hartëzimi i të rinjve;
- Flukset e të rinjve (15-29).Regjistrimet për herë të parë në regjistrin e AKPA sipas zyrave vendore të punësimit, për të kuptuar fluksin e mundshëm të të rinjve NEET që priten të regjistrohen dhe ngarkesën e punës me të cilën do të duhet të përballet stafi i zyrave të punës;
- Vendet e lira të punës të publikuara në raport me numrin total të të papunëve të regjistruar në fund të vitit të kaluar, për të kuptuar dinamikën dhe potencialin e punësimit;
- Mbulimi me institucione të Arsimit dhe Formimit Profesional, për të siguruar ofertën e AFP-së;
- Nr. i punëkërkuesve për çdo specialist për punëkërkuesin (ratio);
- Eksperienca në zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit.

Plani i Zbatimi të Fazës Pilot të Garancisë Rinore në Shqipëri u nda dhe dakordësua nga Koordinatori Kombëtar në Grupin Teknik të Skemës së Garancisë Rinore në muajin tetor 2023 me qëllim lancimin dhe nisjen e zbatimit të Skemës. Kështu me datë 27 tetor 2024, u lancua Faza Pilot e Garancisë Rinore me prezencën e përfaqësuesve të lartë të Delegacionit Evropian në Shqipëri, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shtetit të Fëmijëve dhe Rinisë, si dhe partnerëve të tjerë si ILO, EU4SI, UNICEF, etc.



Me qëllim zbatimin e programit në bashkitë Pilot të Garancisë Rinore, Agjencia Kombëtare e Punësimit gjatë vitit 2023 ka realizuar:

- Trajnimim e stafit të Zyrave të Punës, Qendrave të Formimit Profesional Publik dhe Shkollave Profesionale për zbatimin e fazës Pilot të Garancisë Rinore në tre bashkitë pilot.
- Ndërtimin e procedurës për zbatimin e Skemës së Garancisë Rinore në Shqipëri dhe instrumenteve për monitorimin dhe raportimin e të dhënave lidhur me zbatimin e Skemës.
- Dizenjimin dhe kalimin live të shërbimit të Garancisë Rinore në portalin qeveritar e-Albania,
- Promovimin dhe informimin e punëdhënësve dhe të rinjve të targetuar në 3 rajonet Pilot të Garancisë Rinore, me qëllim përfshirjen e tyre në program.

Muajt nëntor- dhjetor 2023 shënuan aplikimet e para në Skemën e Garancisë Rinore, e cila do të shtrihet gjithashtu në vitin 2024 dhe do të synojë integrimin e të paktën 200 të rinjve në fazën e shërbimit dhe të monitorimit sipas skemës së Garancisë Rinore.

Planifikimi dhe zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit si një instrument për integrimin në tregun e punës së grupeve të disavatazuara

Planifikimi dhe shpërndarja e fondeve bazohet në udhëzimin nr. 25, datë 16.06.2020 i cili përcakton metodologjinë e shpërndarjes së fondeve të programeve të nxitjes së punësimit mbi kriteret të mirëpërcaktuara (nr. Punëdhënësve të regjistruar, nr. Punëkërkuesve të Papunë të regjistruar, treguesit e monitorueshëm për çdo rajon dhe zyrë etj.). Shpërndarja e fondit dhe pjesëmarrësve për PNP 2023, u miratua nga Ministria me shkresën nr. 416/1 datë 24.03.2023 dhe u publikua në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 32 datë 11.04.2023. AKPA hapi aplikimet për Programet e Nxitjes së Punësimit për vitin 2023 dhe i kërkoi drejtorive rajonale detajimin e fondeve sipas çdo zyre vendore punësimi sipas programeve dhe numrit të punëkërkuesve të papunë të përcaktuar në treguesit e monitorueshëm.

Realizimet e indikatorëve dhe fondi i shpenzuar u monitoruan në mënyrë të vazhdueshme, ku në bazë të realizimeve u kryhen ndryshime dhe rishpërndarje të indikatorëve dhe fondeve. Rezulton se ka pasur një shpërndarje mjaft pozitive të fondeve për sa i përket aspektit gjinor pasi në fund të vitit 2023, nga numri total i përfituesve prej 414 individësh, 311 janë gra ose 75 % e totalit. Gjithashtu rezulton se kanë përfutur nga programet 173 subjekte.

Kapitulli III

**ZHVILLIMI I AFTËSIVE DHE
LIDHJA MË E MIRË E KËRKESËS
ME OFERTËN E TREGUT TË
PUNËS PËR MË SHUMË
PUNËSIM, NËPËRMJET
OFRIMIT TË ARSIMIT
DHE FORMIMIT
PROFESIONAL
CILËSOR**



KAPITULLI III- ZHVILLIMI I AFTËSIVE DHE LIDHJA MË E MIRË E KËRKESËS ME OFERTËN E TREGUT TË PUNËS PËR MË SHUMË PUNËSIM, NËPËRMJET OFRIMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR

REDUKTIMI I MOSPËRPUTHJES SË AFTËSIVE PËR TË GJITHA PROFESIONET

Zbatimi i planit të Optimizimit

Në linjë me Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (2023-2023), qeveria shqiptare ka vijuar nismat për reformimin e sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) me synim zhvillimin e aftësive dhe përputhjen më të mirë të kërkesës me ofertën e tregut të punës. Në një ndër masat prioritare të kësaj strategjie është parashikuar që në fazën e parë të zbatimit të strategjisë të përfundojë riorganizimi i ofruesve të AFP-së sipas planit të optimizimit të rrjetit të ofruesve publik dhe në përputhje me zhvillimin e ekosistemit.

Për sa më lart, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërtuar një plan për riorganizimin e rrjetit të ofruesve duke marrë në konsideratë përputhjen e ofertës dhe kërkesën rajonale.

Në zbatim të planit të optimizimit, MFE dhe AKPA kanë përfunduar tashmë këtë proces në shkollat profesionale të qarqeve Durrës, Elbasan dhe Korçë dhe do vijojnë me qarqet e tjera gjatë vitit 2024. AKPA dhe shkollat profesionale pjesë e këtij procesi, si institucione të ngarkuara për zbatimin e këtyre urdhrave kanë ngritur grupet e punës për ristrukturimin. Më konkretisht:

ZHVILLIMI AFTËSIVE DHE LIDHJA MË E MIRË E KËRKESËS ME OFERTËN E TREGUT TË PUNËS PËR MË SHUMË PUNËSIM,

-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 155, datë 30.6.2023 “Për riorganizimin e Shkollës së Mesme Profesionale “26 Marsi“ Kavajë dhe Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Cela” Durrës”, dhe organikën e shkollës profesionale “Beqir Cela” Durrës, miratuar me shkresën e MFE nr. 11561/2, datë 30.6.2023, tashmë këto 2 institucione janë bashkuar në një menaxhim të vetëm **Shkolla Profesionale “Beqir Cela” Durrës.**

-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 50, datë 6.3.2023 “Për riorganizimin e institucioneve arsimore Shkolla e mesme Profesionale “Sali Ceka” Elbasan dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Ali Myftiu” Elbasan dhe Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 155/1, datë 30.6.2023 “Për miratimin e strukturës së institucionit arsimor Shkolla Profesionale Elbasan, tashmë këto 2 institucione janë bashkuar në një menaxhim të vetëm **Shkolla Profesionale Elbasan.**

-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.155/2, datë 30.06.2023 “Për riorganizimin e institucioneve arsimore Shkolla e Mesme Profesionale “Irakli Terova”, Shkolla e Mesme Profesionale “Isuf Gjata”, Shkolla e Mesme Profesionale “Enver Qiraxhi” (Drejtimi Bujqësi)”, dhe organikën e Shkollës Profesionale Shërbime Korçë, miratuar me Urdhrin nr. 205/1 datë 11.09.2023, tashmë këto 2 institucione arsimore dhe drejtimi Bujqësi i shkollës “Enver Qiraxhi”, Pogradec janë bashkuar në një menaxhim të vetëm **Shkolla Profesionale Shërbime Korçë.**

-Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.15976/1, datë 08.09.2023 “Për riorganizimin e institucioneve arsimore Shkolla e Mesme Profesionale “Fan Noli” Korçë, Shkolla e Mesme Profesionale Ndërtimit Korçë, Shkolla e Mesme Profesionale “Demir Progri”, Korçë, tashmë këto 3 institucione arsimore janë bashkuar në një menaxhim të vetëm **Shkolla Profesionale Teknike Korçë**.

Riorganizmi është shoqëruar me:

-ristrukturimin e burimeve njerëzore;

- ndjekjen e procedurave për mbylljen e Nipt-eve të shkollave të optimizuara;

-mbikëqyrjen e procedurave për bashkimin e dokumentacionit të nevojshëm shkollor për çdo nxënës në një arkiv të vetëm dhe të gjithë dokumentacionit lidhur me asetet në një inventar të vetëm;

-mbikëqyrjen e procesit të unifikimit të administrimit financiar në një të vetëm.

Procesi është mbyllur më datë 2 tetor 2023, dhe tashmë 10 shkolla profesionale janë optimizuar.

Gjithashtu, në kuadër të ndryshimit të Urdhrit të Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në nivel qendror dhe rajonal, në muajin qershor janë hartuar strukturat e reja të 10 Qendrave të Formimit Profesional Publik, të cilat janë miratuar me urdhrin nr.10168, datë 05.06.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikave të QFPP-ve”, të MFE. Ky proces është shoqëruar me monitorimin e vënies në zbatim të këtyre strukturave.

Procesi i riorganizimit të QFP-ve sipas strukturave të reja ka përfunduar në fund të gushtit 2023.

Përmirësimi i infrastrukturës së IOAFP-ve

Përveç optimizimit në nivel sistemi, një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe optimizimit në nivel ofruesi, duke u përqendruar në përmirësimin e infrastrukturës mësimore.

Rikonstruksione

Në 5 vitet e fundit rezulton të jenë rikonstruktuar kryesisht me fondet e MFE-së 16 shkolla të mesme profesionale. Gjatë vitit 2022-2023 më specifikisht janë rikonstruktuar/investuar institucionet e mëposhtme:

-Shkolla “Hoteleri-Turizëm”, Tiranë;

-Shkolla “Nazmi Rushiti”, Dibër;

-Baza prodhuese e Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës;

Rikonstruksioni ka përfunduar në të dy shkollat, dhe ka filluar zhvillimi i mësimit gjatë vitit shkollor 2023-2024.

Në buxhetin e ministrisë për vitin 2024 janë parashikuar ndërhyrjet në infrastrukturën e shkollave profesionale si më poshtë:

-Shkolla e Mesme Profesionale “Hasan Gina”, Lushnje

- Shkolla e Mesme Profesionale “Hysen Çela”, Durrës (shtesa)
- Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë (Baza prodhuese)
- Shkolla e Mesme Pavarësia, Vlorë (rikonstruksion godina kryesore)
- Rikonstruksione të pjesshme në 3 shkolla të tjera.

Një tjetër mundësi e rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës ka qenë projekti Regional Challenge Fund (RCF). Gjatë vitit 2023 RCF ka shpallur thirrjen e tretë për shprehje interesi për aplikime për financim. Thirrja ka qenë e hapur deri në datën 7 korrik. Ky instrument i Bankës Gjermane për Zhvillim (KFW) ofron mbështetje për rritjen e konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve në ekonomitë e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor duke financuar investime në pajisje, infrastrukturë ose trajnime të zbatuara përmes, partneriteteve ndërmjet IOAFP-se dhe sipërmarrjeve. Në këtë kuadër, gjatë muajit qershor pas zhvillimit të 3 sesioneve informuese mbi përshtatshmërinë e aplikantëve, kriteret, mënyrën dhe procedurat e aplikimit për përfitimin e mbështetjes së ofruar, gjatë fazës së parë të Thirrjes së tretë për Propozime për Projekt (viti 2023) kanë aplikuar përkatësisht 23 ofrues publik të AFP. Në fazën e dytë të thirrjes u kualifikuan 16 IOAFP, përkatësisht:

1. Shkolla Profesionale “Mihal Shahini”;
2. Shkolla e Mesme Bujqesore “Rakip Kryeziu”;
3. Shkolla Profesionale Teknike, Korçë;
4. Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë;
5. Shkolla e Mesme Profesionale “Antoni Athanas”;
6. Shkolla Profesionale “Hamdi Bushati”;
7. Shkolla e Mesme Profesionale Hoteleri Turizëm;
8. Shkolla Profesionale “Beqir Cela”;
9. Qendra e Formimit Profesional, Elbasan
10. Shkolla Profesionale Elbasan;
11. Shkolla Industriale Pavarësia;
12. Shkolla Tregtare, Vlorë;
13. Shkolla “Hermann Gmeiner”;
14. Shkolla e Ndërtimit “Karl Gega”;
15. Shkolla Profesionale “Hysen Çela”, Durrës;
16. Shkolla “Demir Progri” në partneritet QFPI.

Lidhur me aplikimet e dërguara gjatë vitit 2022, nga 6 institucionet ofruese të AFP-së që kishin kaluar në fazën e dytë, janë shpallur fitues Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” dhe Shkolla Teknike Ekonomike, Tiranë.

Mbështetje me kabinete dhe pajisje

Institucionet ofruese të AFP gjatë vitit 2023 janë mbështetur gjithashtu me kabinete dhe pajisje didaktike. Këto institucione janë mbështetur nga 2 burime kryesore, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe donatorëve/projekteve në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional.

Është investuar në blerje kabineti kuzhine, repart axhusterie dhe saldimi, repart teknologjie të automatizuar, repart hidraulike, repart automekanike, laborator IT, repart për elektroteknikën, për termohidraulikën, për disa IOAFP.

a) Nga investimi i MFE janë siguruar:

- Kabinet kuzhine në Shkollën “Kolin Gjoka”, Lezhë;
- Repart axhusterie dhe saldimi në Shkollën “Karl Gega”, Tiranë;
- Repart i teknologjisë së automatizimit/Akademia e Inovacionit në Shkollën “Gjergj Canco”, Tiranë;
- Repart hidraulike në Shkollën “Beqir Çela”, Durrës;
- Repart axhusterie dhe saldimi si dhe një laborator IT në Shkollën Profesionale Elbasan;
- Repart SHMT-je, repart për Elektroteknikën si dhe repart për Termohidraulikën në Shkollën Profesionale “Hasan Gina”, Lushnjë;
- Repart automekanike në Shkollën Profesionale Teknike, Korçë.

b) Nga investimet e donatorëve/projekteve janë siguruar:

- 34 kompjutera për Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela”;
- 34 kompjutera për Shkollën e Mesme të Ndërtimit “Karl Gega”;
- 34 kompjutera për Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz;
- 17 kompjutera për Shkollën e Mesme Profesionale “Petro Sota”;
- 17 kompjutera për Shkollën Mekanike Bujqësore “Hasan Gina”;
- 17 kompjutera për Shkollën e Mesme Profesionale “Stiliano Bandilli”;
- 1 kabinet IT-je për Shkollën e Mesme Profesionale “Nazmi Rushiti”, Dibër;
- 2 kabinate (kuzhinë dhe kabinet fotovoltaike) në QFP Elbasan;
- 1 kabinet kuzhine për Shkollën “Nazmi Rushiti”, Dibër;
- 1 kabinet kuzhine për QFP-në Gjirokastrë.

Ndërkohë për herë të parë gjatë vitit 2023 janë nënshkruar 3 kontrata dhurimi ndërmjet shkollave që ofrojnë drejtimin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi dhe bizneseve nëpërmjet së cilave, Shkolla “Thoma Papapano”, Gjirokastrë ka përftuar 14 lap top, Shkolla Industriale Pavarësia do të marrë në dorëzim 30 kompjutera dhe Shkolla e Mesme Profesionale “Petro Sota” do të marrë në dorëzim 20 kompjutera. Ndërkohë njeri prej projekteve ka investuar në shkollat partnere 60 pajisje digjitale për kabinate dhe zyrat e njësisë së zhvillimit.

Po ashtu paraprakisht për vitin 2024 AKPA ka dakordësuar marrëveshjen për mbështetjen e disa ofruesve deri në muajin prill të vitit 2024, me kabinate dhe pajisje digjitale. Më specifikisht me 4 kabinate (kuzhine, restoranti, teknologjie ushqimore dhe bari), 83 kompjutera, 5 video projektorë dhe 3 fotokopje shumëfunksionale.

Rritja e pjesëmarrjes në AFP (Viti i Aftësive)

Plani i aktiviteteve të promovimit

Në kuadër të promovimit dhe rritjes së pjesëmarrjes në AFP, AKPA e frymëzuar nga Agjenda Evropiane e Aftësive, si dhe në mbështetje të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030, në fillim të vitit 2023 ndërtoi planin institucional të aktiviteteve të vitit evropian të aftësive. Në këtë kontekst u zhvilluan një seri aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse duke stimuluar dhe nxitur dialogun ndërmjet palëve të interesuara për nevojën për një fuqi punëtore të kualifikuar dhe rritjen e numrit të regjistruarve në arsim dhe formim profesional. Aktivitetet e zhvilluara në zbatim të këtij objekti janë fokusuar jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në nivel ofruesi. Ato dhe janë konsultuar me drejtuesit e IOAFP-ve në takimet rajonale që u organizuan në muajin shkurt dhe kanë filluar të zbatohen nga data 1 mars duke vijuar deri në fillimin e vitit shkollor 2023-2024.

Aktivitetet promovuese të realizuara gjatë kësaj periudhe në nivel shkolle paraqiten si më poshtë:

- Nga 2907 shkolla 9-vjeçare në rang vendi, numri total i shkollave të vizituara në kuadër të promovimit ka arritur në 1967.
- Janë kontaktuar 2676 familje të nxënësve të klasave të 9-ta.
- Për promovimin e shkollave profesionale janë realizuar 170 intervista në televizionet lokale.
- Nga marsi e në vijim, shkollat profesionale kanë marrë pjesë në 93 panaiere.
- Gjithsej janë realizuar 699 takime me aktorë të ndryshëm të tregut të punës si biznese, Zyrat e Punës, Zyrat Arsimore në bashki, shoqatat e turizmit dhe hotelierisë dhe institucione të tjera.
- Postimet në rrjetet sociale arrijnë një total prej 5000.
- Janë zhvilluar gjithsej 634 aktivitete të këshillimit për karrierë, të tilla si takime me nxënës të klasave të 9-ta, takime me nxënës të klasave të XI-ta për profilizimin, dhe njohja e nxënësve të klasave të X-ta me modele CV, letra motivimi apo kërkesa punësimi.
- Nxënësit e të gjitha shkollave profesionale kanë marrë pjesë në një total prej 119 konkursesh të zhvilluara si nga vetë shkolla ashtu dhe në nivel rajoni me tematika të tilla si: Olimpiada botërore e ekonomisë, Re-debate, konkurse në fushat e pikturës, muzikës, volejbollit dhe futbollit.

Bashkëpunimi ndërinstitucional me MAS për rritjen e numrit të regjistrimeve

Gjithashtu me fokus nxitjen e regjistrimeve në arsimin e mesëm profesional me Urdhrin nr.23, datë 27.01.2023 është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me përfaqësues nga MFE, MAS, AKPA dhe DPAP. Ky grup pune ka kryer një analizë të arsimit të mesëm të sistemit parauniversitar me fokus nxitjen e regjistrimeve në arsimin e mesëm profesional. Grupi i punës dakordësoi draftin dhe vendosi rikonceptimin e shërbimit për aplikim në e-Albania për regjistrim në shkollë të mesme profesionale. Prej datës 10.11.2023 është bërë aktiv shërbimi i ri në SMIP “Transferim nga gjimnazi në shkollë profesionale”.

Referuar raportimit lidhur me transferimet nëpërmjet SMIP nga gjimnazi në shkollë profesionale deri më datë 20 dhjetor 2023 rezulton se nga shkollat janë kontaktuar gjithsej 304 gjimnaze në 12 qarqet e vendit dhe kanë aplikuar 387 nxënës për transferim në shkollë profesionale. Shkollat profesionale, pas kontaktimit të prindërve dhe nxënësve kanë pranuar 332 transferime, dhe kanë kryer 16 refuzime për arsye të mospranimi të prindit apo nxënësit për transferim.

Përmirësimi instrumentave dhe rritja e gamës së kanaleve të informimit për AFP

a) Në bashkëpunim me UNICEF, u ndërtua dhe aktivizua rrjeti i profesionistëve për 3 ndër fushat kryesore të zhvillimit ekonomik, të cilat janë: Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit, Bujqësia dhe Hoteri-Turizëm. Nëpërmjet ekspertizës është hartuar koncepti mbi strukturimin e këtij procesi i cili do të zhvillohet në dy rrafshë, atë fizik dhe atë virtual. Drafti i hartuar u konsultua me drejtuesit e shkollave dhe në vijim u dakordësua plani i aktiviteteve që do zhvillohen në kuadër të kësaj nisme. Në maj 2023 u lancua faqja zyrtare për rrjetin e parë të profesionistëve në Shqipëri <https://afpro.al/>.

AFPro është një platformë e cila bashkon studentë, mësues, sipërmarrës dhe biznese, profesionistë të rinj dhe politikbërës, në një komunitet të fortë dhe të qëndrueshëm. Ajo ka për qëllim të nxisë arsimin cilësor, të pasurojë ndërveprimet shkollë-biznes dhe të promovojë potencialet e karrierës në sistemin e AFP. Nëpërmjet këtij instrumenti synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe informacioni mbi ofertën e AFP. Në këtë kuadër janë zhvilluar një sërë aktivitete nëpërmjet mentorëve me synim promovimin e AFP, ku mund të përmendim:

- *Hack for Albania* i cili synonte ekspozimin e pjesëmarrësve ndaj kodimit dhe dizajnit me në qendër njeriun. Ky aktivitet bashkoi ekspertë të rinj dhe teknologjinë për të punuar së bashku në ekipe, duke zgjidhur problemet e botës reale.

- *Pyet Mentorët* i cili u zhvillua në 2 sesione. Përmes tyre synohej informimi mbi arsimin/formimin profesional, këshillimi i karrierës, shkëmbimi i mendimeve dhe dhënia e ekspertizës në fushat e TIK, Hoteleri-Turizmit dhe Bujqësisë.

- *Aftësitë e buta*, të zhvilluara gjithashtu në 2 sesione nëpërmjet platformës zoom. Nëpërmjet këtij aktiviteti synohej mbështetja e nxënësve për kalimin nga shkolla në punë, duke u fokusuar të rëndësia e aftësive të buta. Ky forum trajtoi tema si: aftësitë e buta përpara aplikimit për punë (fuqia e networking), gjatë procesit të aplikimit (intervistat e punës) dhe në punë.

- *Festivali i Ushqimit* u organizua në datën 25 tetor 2023 në Shkollën Profesionale Elbasan, duke bërë bashkë nxënësit e arsimit dhe formimit profesional të drejtimit Hoteleri-Turizëm nga 10 qytete të Shqipërisë.

- *Aktiviteti 'Ditët e Shkëmbimit'* u zhvillua në datën 22 nëntor 2023 në Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz. Përmes bashkëpunimit me partnerët dhe bizneset kryesore në këto industri, nxënësit patën rastin të eksplorojnë mundësi të ndryshme profesionale, të njihen me përfaqësues të bizneseve të industrive, të këshillohen për karrierën si dhe të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional.

b) Në qershor 2023 u përfundua një faqe e dedikuar për AFP-ne <http://aftesi.al/>. Kjo faqe zyrtare është krijuar për t'i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve që dëshirojnë të marrin informacion të detajuar dhe përditësuar rreth AFP në Shqipëri. Edhe ky instrument synon të rrisë nivelin e informimit mbi programet, kurset dhe nismat e lidhura me arsimin dhe formimin profesional.

Organizimi dhe pjesëmarrja në panaire

-International Food & Drink Expo 2023, Edicioni i 5-të. Ky Panair Ndërkombëtar, në edicionin e tij të 5-të, u zhvillua në datat 23-25 maj 2023, me pjesëmarrës nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Bashkia Tiranë. Si pjesë e këtij panairi u organizua dhe Konkursi “Gastro Alb 6” i cili është konkursi më i rëndësishëm deri më tani për sektorin. Në këtë konkurs morën pjesë të 12 shkollat e mesme profesionale që ofrojnë drejtimin hotelieri-turizëm.

-Panairët Work& Study, të organizuar nga AKPA dhe Dhoma e Tregtisë. Këto panaire u zhvilluan në të 12 rajonet nga datat 27 shkurt-28 mars, me pjesëmarrjen e Zyrave të Punës, Qendrave Publike të Formimit Profesional dhe Shkollave të Mesme të Arsimit Profesional. Panairi final u zhvillua në datat 24-26 prill 2024 në Tiranë, dhe në të morën pjesë 6 shkolla dhe 3 QFP, me stendat e tyre si dhe një stendë për programin e kodimit.

-Panairi Future2Tech2023, (21-22 shtator 2023). Gjatë dy ditëve të panairit, mësues dhe nxënës/e të shkollave profesionale që ofrojnë drejtimin Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, së bashku me stafin e S4J, shpalosën për vizitorët përdorimin dhe ndërthurjen e teknologjive të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, përdorimin e platformave moodle dhe të industrisë si Cisco Academy, metodologjinë e pasurimit të kurrikulës së zbatuar me materiale digjitale mësimore, përdorimin e Zoom dhe Google Classroom për mësimin online dhe hybrid dhe vlerësimin e nxënësve përmes Kahoot etj.

-Panairi i punës dhe karrierës, Automotive Fair Albania, (26-29 tetor 2023). Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ishte prezantimi i të rinjve me tregun automotiv, kualifikimi dhe aftësimi i tyre në përputhje me sfidat e reja në tregun e punës, lidhur me kriteret e bizneseve, si dhe studimi i trendeve më të reja në treg. Shkollat profesionale pjesëmarrëse ishin: Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela” dhe Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz. AKPA u përfaqësua në forumin “Start-Up Solutions and Innovation”.

-Panairi Agrotech 2023 “Expocity Albania”. Konkursi i shkollave profesionale, (18-20 tetor 2023). Në ambientet e ExpoCity Albania, në datat 18-20 tetor u zhvillua edicioni i 4-ët i panairit të bujqësisë “Agrotech Expo”, ku morën pjesë shkollat profesionale që ofrojnë drejtimin bujqësi. Pjesëmarrja e shkollave ishte në formën e një konkursi.

Iniciativa në kuadër të fuqizimit dhe ndërkombëtarizimit të shkollave profesionale

Programi rajonal shkëmbimit/mobilitetit Supershkollat

Programi i Shkëmbimit të Shkollave në Ballkanin Perëndimor “Supershkollat” ka për qëllim ndërtimin e paqes dhe të pajtimit në Ballkanin Perëndimor, dhe është një projekt i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Këtë vit u zgjodhën 9 shkolla të mesme profesionale për të qenë pjesë e mobilitetit në rajon, si më poshtë: Shkolla e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”, Shkolla Profesionale “Hamdi Bushati”, Shkolla Tregtare, Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak”, Shkolla e Mesme Profesionale “Petro Sota”, Shkolla e Mesme Profesionale “Salih Ceka”, Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz dhe Shkolla e Mesme e Agrobiznesit Golem “Charles Telford Erickson”.

Programi i debatit “Re-Debate”

Në kuadër të projektit “QENDRO”, UNICEF këtë vit ka mbështetur projektin kombëtar “Re-Debate” të zbatuar nga organizata Liburnetik, duke përfshirë dhe 14 shkolla profesionale. Qëllimi kryesor i projektit ishte promovimi i kulturës së debatit nëpërmjet zhvillimit të aftësive komunikuese, të menduarit kritik dhe inkurajimit të tolerancës dhe respektit mbi idetë e ndryshme të nxënësve të shkollave të mesme. Projekti u zbatua gjatë periudhës shkurt – korrik 2023 në shkollat e mesme të qyteteve të Shqipërisë.

*Në referencë të politikave dhe aktiviteteve të ndërmarra për fuqizimin dhe promovimin e sistemit të AFP, rezulton se gjatë vitit 2023 ka pasur një rritje domethënëse të numrit të regjistrimeve. Aplikimi për regjistrim në klasat e X-ta në shkollat e mesme profesionale ka qëndruar i hapur për periudhën 7 korrik - 30 shtator 2023, periudhë gjatë së cilës janë regjistruar gjithsej 4377 nxënës, prej të cilëve 724 vajza. Ndërkohë, pas përfundimit të fazës së dytë rezultojnë të regjistruar në total në klasat e X-ta **4709** nxënës ose **11%** më shumë se një vit më parë. Kjo shifër merr më tepër rëndësi nëse marrim në konsideratë faktin që numri i të diplomuarve në shkollat 9-vjeçare për shkak të zhvillimeve demografike është në trend rënës.*

Programi i formimit profesional

Çdo qytetar që është i interesuar për t'u regjistruar në kurs formimi profesional aplikon përmes portalit unik qeveritar e-Albania, në shërbimin “Aplikim për regjistrim për kurs formimi profesional”, nga ku edhe merret informacioni i duhur në lidhje me kërkesën e tyre nga drejtoria përkatëse (qendra e formimit) së cilës i janë drejtuar. Programet e formimit profesional të ofruara nga qendrat publike të formimit profesional mbeten një ndër instrumentat më të rëndësishëm për kualifikimin, rikualifikimin apo kualifikimin e mëtejshëm të forcës punëtore. Gjatë vitit 2023 janë ofruar 71 kurse të ndryshme, në nivel kombëtar dhe në nivel qendre dhe referuar statistikave për 12-mujorin vihet re se janë regjistruar 15,134 kursantë, nga të cilët 10,547 kanë qenë punëkërkues të papunë (pu.pa).

Prej pu.pa.-ve pjesëmarrës në Formim Profesional:

- 228 romë/egjiptianë;
- 119 P.A.K
- 842 Ndihmë ekonomike
- 967 Numri i bizneseve partnere me QFP-të

Krahasuar me vitin 2022, vihet re se objektivi vjetor është arritur para përfundimit të 12-mujorit dhe rezulton se targeti vjetor i pu.pa.-ve të regjistruar është realizuar në masën 131%.

Zbatimi i kurrikulës për Aftësi Digjitale për pu.pa.

Në fillim të vitit 2023, AKPA, në bashkëpunim GIZ, ka nisur programin e trajnimit “Aftësi Digjitale” në të gjitha Qendrat Publike të Formimit Profesional në vend. Kurrikula është e ndarë në 2 nivele dhe përmban 5 kompetencat bazë digjitale sipas EU Digital Competencies Framework 2.0. Ky program synon të pajisë punëkërkuesit me aftësitë bazë digjitale të cilat lehtësojnë aksesin në tregun e punës. Nëpërmjet saj sigurohen dhe aftësi të tilla si kërkimi online i punëve apo përdorimi i portalit e-Albania. Kurrikula është zbatuar përmes laboratorëve të IT të këtyre Qendrave, të pajisur nga programi dhe ka mundur përfshirjen në këtë kurs të 2334 punëkërkuesve prej të cilëve 1990 pu.pa., në të gjithë Qendrat Publike të Formimit Profesional në vend. Krahas trajnimit, është punuar për të rritur kapacitetet e stafit mësimdhënës të këtyre Qendrave, për të vijuar ofrimin e trajnimit sipas nevojave të punëkërkuesve të papunë për aftësitë digjitale.

Zbatimi i Programit të Formimit Profesional nëpërmjet Mbështetjes Financiare me qëllim përfshirjen e të paktën 1000 punëkërkuesve

Në vitin 2023 janë ofruar 36 kurse me mbështetje financiare nga 7 Institucione të Formimit Profesional Privat. Aplikimet për përfshirjen në këtë program janë kryer nëpërmjet platformës e-Albania në shërbimin “Aplikim për kurs formimi me mbështetje financiare”. Për periudhën janar-dhjetor kanë shprehur interes për zhvillimin e kurseve me mbështetje financiare **5225** aplikantë, nga këto:

- kanë pranuar kushtet për ndjekjen e një kursi formimi me mbështetje financiare dhe kanë kaluar testimin paraprak 1947 persona.
 - kanë nisur kursin 1291 aplikantë, nga të cilët 156 janë punëkërkues të papunë.
- Kursi më i kërkuar rezultoi “JAVA” i cili ka rreth 25% të totalit të kursantëve.

Diversifikimi i Ofertës në AFP në Përputhje me Nevojat e Tregut të Punës

Në kuadër të vlerësimit të relevancës së ofertës së AFP, gjatë 6-mujorit të parë 2023 në bashkëpunim me Drejtorinë e Performancës dhe Informacionit të Tregut të Punës është kryer një analizë mbi ofertën aktuale, ku janë analizuar regjistrimet në programe gjatë vitit të fundit, kapacitetet e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore dhe nevojat e tregut rajonal të punës me qëllim përshtatjen e ofertës së AFP-së me nevojat e tregut të punës. Analiza ka synuar identifikimin e drejtimeve të reja që duhen hapur, kryesisht TIK dhe mbylljen e drejtimeve të cilat nuk janë më relevante me tregun rajonal të punës. Në përfundim të këtij studimi, u hartua edhe një draft propozim i ofertës së rishikuar të AFP-së sipas 4 rajoneve për vitin 2023-2024.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës shkurt-mars 2023 AKPA ka ndërmarrë një seri takimesh rajonale nën temën “Planifikimi afatmesëm i ofertës së AFP-së”. Bazuar në rekomandimet e dërguara nga AKPA, shkollat kanë marrë masat përkatëse për rishikimin e ofertës mësimore për vitin shkollor 2023-2024, ndërsa QFP-të për hapjen e kurseve të reja të kërkuara nga tregu i punës.

Më poshtë paraqiten drejtimit e reja të hapura në shkollat e mesme profesionale:

- Drejtimi pas të mesmes (niveli V i KSHK) “Diagnostikim-Menaxhim në Autoservis” në Shkollën Profesionale Teknike Korçë.
- Drejtimi pas të mesmes (niveli V i KSHK) “Dizenjim Mode”, në Shkollën Profesionale Shërbime Korçë.
- Drejtimi pas të mesmes (niveli V i KSHK) “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtshme” në Shkollën e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka”, Lezhë.
- Drejtimi pas të mesmes (niveli V i KSHK) “Diagnostikim-Menaxhim në Autoservis” në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela”, Durrës.
- Drejtimi pas të mesmes (niveli V i KSHK) “Dizenjim Mode”, në Shkollën “Hysen Çela”, Durrës.
- Drejtimi mësimor “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në Shkollën e Mesme Profesionale Bujqësore Kamëz.

Më poshtë paraqiten kurset e reja afatshkurtra të hapura në qendrat e formimit profesional:

- Kursi i formimit profesional “Grafik dizajn” në QFP Zona Verilindore.
- Kurset e formimit profesional “Marketingu digjital” dhe “Instalim i paneleve diellore fotovoltaike” në QFP Elbasan.
- Kurset e formimit profesional “Grafik dizajn” dhe “Picajol” në QFP Shkodër.
- Kurset e formimit profesional “Tipografi” dhe “Shërbime shitjeje” në QFP Nr.4 Tiranë.
- Kurset e formimit profesional “Përpunim mishi”, “Përpunim fruta perime” dhe “Shërbime shitjeje” në QFP Durrës.

Gjithashtu AKAFP&K ka hartuar 6 kurrikula të reja dhe ka rishikuar 6 kurrikula ekzistuese, të cilat janë miratuar në MFE më datë 20.03.2023 dhe zbatuar gjatë vitit 2023.

Për vitin 2024 është parashikuar hartimi i 2 kurrikulave të reja dhe rishikimi i 9 kurrikulave ekzistuese. Kurrikula të reja të planifikuara për t'u hartuar janë "Zhvillimi front end (Front end development)" dhe "Hedhje të dhënash (Data Entry)".

Përmirësimi i Sistemin e QFP-ve dhe skemës së ndërlidhjes midis Sistemit të shërbimeve të punësimit

Në zbatim të kontratës së përmirësimit të sistemit të shërbimeve të punësimit me module të reja për AKPA, gjatë vitit 2023 është krijuar formati i aplikimit nga e-albania dhe referimet që do vijnë nga Zyra e Punës. Në të njëjtën kohë janë finalizuar dhe skedat për programin, punonjësit, kalendarin, kurset, regjistrin, biznesin, kursantin, faturat dhe librin e amzës dhe formati i certifikatës që do të gjenerohet në mënyrë elektronike.

Për të gjitha skedat e mësipërme në bashkëpunim me sektorin e IT është kryer analiza përkatëse duke përfshirë funksionalitetet dhe ndërlidhjen me modulet si dhe është kryer dërgimi analizës pranë kompanisë zhvilluese.

Databaza e praktikave profesionale në biznes AP

Pas verifikimit të databazës së praktikave profesionale ka rezultuar që shkollat e mesme profesionale gjatë vitit shkollor 2022 – 2023 kanë bashkëpunuar me 2677 subjekte për zhvillimin e praktikave profesionale.

- 2586 biznese private
- 85 institucione publike
- 6 OJF

Në total 6314 nxënës kanë kryer praktikat profesionale në biznes prej të cilëve:

- 704 janë nxënës në klasë të X
- 1722 nxënës në klasë XI
- 2310 nxënës në klasë XII
- 1578 nxënës në klasë të XIII

Databaza e burime njerëzore

Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të AFP-së dhe Drejtorinë e Performancës dhe Informacionit të Punës kanë ndërtuar databazën e burimeve njerëzore e cila përmban jo vetëm të dhënat personale për stafet e IOAFP-ve, por edhe të dhënat profesionale si dhe trajnimet e zhvilluara si për bazat e didaktikës ashtu edhe të zhvillimit të vazhduar profesional si dhe trajnimet e tjera profesionale. Kjo databazë përditësohet në vijimësi, varësisht nga proceset e qarkullimit të stafit në IOAFP.


Gjurmimi në nivel Kombëtar për të diplomuarit/certifikuarit e AFP

Drejtoria e Performancës dhe Informacionit të Punës në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të AFP-së dhe me mbështetjen e projektit Skills 4 Jobs kanë përfunduar anketën e gjurmimit në nivel kombëtar për vitin 2023 të të diplomuarve 2021-2022 nga shkollat dhe të certifikuarve 2022 nga QFP-të. Janë realizuar të gjitha hapat që lidhen me procesin e gjurmimit, si më poshtë:

- Takimi me ekspertin e metodologjisë mbi kampionimin dhe anketën;
- Përgatitja e databazave finale me popullatën e të diplomuarve 2022 nga shkollat e AP dhe të certifikuarit 2022 nga DROFPP-të;
- Rishikimi i pyetësorëve të gjurmimit për shkollat dhe qendrat;
- Anonimizimi i databazave të popullatës;
- Pilotimi demografik për vendosjen e qasjes metodologjike;
- Mobilizimi i intervistuesve që do të administrojnë pyetësorët;
- Trajnimi i 10 intervistuesve për metodologjinë dhe administrimin e gjurmimit në nivel kombëtar;
- Realizimi intervistave;
- Gjenerimi i Raportit Përfundimtar.

Në kuadër të prezantimit të gjetjeve dhe rezultateve të gjurmimit në nivel kombëtar për të diplomuarit dhe të certifikuarit e AFP, në datën 26 tetor u zhvillua aktiviteti **“Integrimi në tregun e punës për të diplomuarit/certifikuarit e AFP”**. Ky takim shërbeu dhe si një hapësirë diskutimi mbi zhvillimet e ndodhura në AFP në funksion të rritjes së cilësisë dhe integritetit të qëndrueshëm në tregun e punës të të diplomuarve dhe certifikuarve.

Rezultatet kryesore për të diplomuarit në shkollat profesionale:



Rezultoi se rreth 59.5% e të diplomuarve ishin punësuar dhe 23.1% kishin vijuar studimet në universitetet apo ishin në formim të mëtejshëm.

Krahasuar me një vit më parë, ka një rritje të lehtë të punësimit, në nivelin 2 pikë përqindje. Në vitin 2022, është ulur numri i të vetëpunësuarve në 6.7% nga 8% në vitin 2021, ndërsa është rritur grupi i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë (13% nga 11.2% në vitin 2021).

- Drejtimi me punësimin më të lartë në vitin 2022, ashtu si dhe një vit më parë, është Hoteleri-Turizëm (70.7%) ndërsa drejtimi që ka pasur rritjen më të madhe të punësimit është Elektronika (67.6% në 2022 nga 55.4% në 2021).
- Më shumë se gjysma e të diplomuarve në marrëdhënie pune, janë punësuar që para diplomimit/mbarimit të shkollës.
- Më shumë se një e treta e të diplomuarve të punësuar, ashtu si dhe një vit më parë, kishin të ardhura nga puna në intervalin 40.001-50.000 lekë. Ndërkohë është rritur me rreth 10 pikë përqindje pesha e të punësuarve me paga në fashat 50.001-95.000 lekë. Ndonëse në përqindje të vogla, rritje kanë pësuar edhe pagat e fashës mbi 95.000 lekë (7.4% në 2022 nga 3.5% në 2021).
- Në vitin 2022, të diplomuarit e punësuar me drejtimet Ekonomi-Biznes dhe Elektroteknikë punojnë me paga të larta (më shumë se një e treta e tyre paguhet në intervalin 60.001-90.000 lekë).
- Rritet relevanca e profileve të studimit në arsimin profesional, me 63.4% të të diplomuarve të punësuar që pohojnë se fusha e studimit të tyre është e lidhur me punën që kryejnë. Në vitin 2021, kjo përqindje ishte 50%. Hoteleri-Turizëm është drejtimi në të cilin shfaqen më shumë të diplomuar të punësuar që pohojnë relevancën e studimeve me punën që kryejnë (82.3%).

Rezultatet kryesore për të certifikuarit në QFP:

	2022	2021	2019
I/E punësuar	44.3%	43.7%	39.0%
I/E vetë-punësuar	16.1%	14.4%	8.8%
Punoj dhe studioj (ose trajnohem) në të njëjtën kohë	0.5%	0.7%	0.6%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	15.4%	20.3%	31.8%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	10.7%	13.1%	8.8%
Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	7.1%	5.4%	4.1%
Në paaftësi të përhershme	0.8%	0.3%	0.5%

Rezultoi se rreth rreth 60.9% e të anketuarve kanë deklaruar që janë të punësuar pas përfundimit të kursit. Krahasuar me një vit më parë, ka një rritje të punësimit, në nivelin 2.1 pikë përqindje.

- Përqindjen më të lartë të të punësuarve e kanë qendrat Kamëz, QFP Vlorë, QFP Nr.1, QFP Korçë dhe QFP Nr. 4 Tiranë.
- 22.7% e të anketuarve nga përqindja e të punësuarve, kanë deklaruar të ardhura 40.000–50.000 lekë.
- 52.9% e të certifikuarve kanë deklaruar se trajnimi dhe puna e tyre kanë lidhje me njëra-tjetrën.

Licencimi dhe monitorimi i ofruesve privatë të AFP-së


Gjatë vitit 2023, janë shqyrtuar kërkesat dhe ndjekur procedurat, për 191 aplikime për licencim për formim profesional, ndërkohë që janë dërguar në MFE 186 relacione dhe 5 janë në proces.

Kërkesat e subjekteve për licencë për formim profesional apo për modifikim në licencat ekzistuese, të ndara sipas muajve të vitit, paraqitet si më poshtë:




Në krahasim me vitin 2022, vihet re se në total numri i aplikimeve është pothuajse i njëjtë, ndërsa përsa i përket shpërndarjes në muajt: muajt janar, maj, qershor dhe tetor kanë numrin më të lartë të aplikimeve. Kërkesa ka pësuar rënie në tre muajt e verës, si dhe në fund të vitit për shkak të ndryshimeve në mënyrën e aplikimit nga QKB, (si për ndryshimin në licence ashtu dhe për licence të re).

Aplikimet/ Kërkesat të ndara sipas qarqeve, paraqiten si më poshtë:



Në krahasim me vitin 2022, kemi një rritje të numrit të kërkesave në qarkun e Tiranës me 4.5% dhe vihet re se ka pësuar rënie numri i kërkesave në rajonin e Durrësit me 41%.


- Sipas arsyes së aplikimit:



Referuar aplikimeve, 128 kërkesa janë për licencë të re dhe 63 janë për ndryshim në licencën ekzistuese ku dominon kërkesa për shtim të listës së kurseve (69.8% e totalit të aplikimeve për ndryshim licence).


- Sipas vlerësimit të dhënë nga AKPA

Pas shqyrtimit të dokumentacionit aplikues të subjekteve, si dhe verifikimit në vend të kushteve paraprake të licencimit, është dhënë vlerësimi përkatës për 186 procedura aplikimi të përfunduara si më poshtë:



Vlerësimet negative kanë ardhur kryesisht për mospërbushje të kriterëve të licencimit për stafin mësimdhënës, kryesisht për mospërbushje të kriterit të eksperiencës së punës minimalisht 5 vite të drejtuesit didaktik (40% e totalit të subjekteve me vlerësim negativ). Gjithashtu, 10 aplikime janë vlerësuar negativisht për mospërputhje të deklarimeve për adresën, për sipërfaqen e ambientit, ndërkohë që 6 aplikime rezultuan se nuk përmbushnin të tre kriteret e licencimit.

- Sipas kurseve që kërkojnë të ofrojnë, kërkesat e subjekteve aplikuese ndahen si më poshtë:



Në krahasim me vitin 2022, vihet re i njëjti trend i kërkesave për ofrim të kurseve të parukerisë dhe estetikës dhe nga ana tjetër ka pësuar rënie numri i kërkesave për ofrimin e kurseve në fushën e financës dhe të hotelieri –turizmit. Është rritur dukshëm kërkesa për ofrimin e kurseve në fushën e programimit, kjo ndikuar dhe nga reforma e digjitalizimit ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare.

FUNKSIONIMI MË I MIRË I TREGUT TË PUNËS PËR TË GJITHË

Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara

Në mars 2023, AKPA ka nisur ciklin e takimeve me Aleancën Franceze për Zhvillim, me qëllim zbatimin e Programit të Asistencës Teknike (AT) të ofruar nga Expertise France (EF), i cili synon të mbështesë përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të zbatuar veprimet prioritare të Matricës së Politikave, dhe në përgjithësi për të rritur barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në ekonomi.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Expertise France kanë dizenuar dhe validuar një paketë gjithëpërfshirëse shërbimesh dhe programesh punësimi të përshtatura për gratë që banojnë në zonat rurale dhe zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen plotësisht nga shërbimet publike të punësimit. Tre bashki do të përfshihen në zbatimin pilot të kësaj paketë, të cilat janë Elbasani, Lushnja dhe Kamza. Kjo paketë bazohet në një studim të mëparshëm analitik mbi rrethanat dhe nevojat e veçanta të grupit të synuar të cilat janë gratë që jetojnë në zona rurale dhe/ose në zona të tjera që aktualisht nuk mbulohen nga Shërbimet Publike të Punësimit. Kjo iniciativë po pilotohet në kushtet kur midis 2019-2021, paketa e Programeve Aktive të Tregut të Punës (PATP-ve) është përditësuar dhe është realizuar një diversifikim i ofertave. Në përfundim të projektit ndër të tjera do të përcillen propozime konkrete mbi shtrirjen territoriale të shërbimeve nëpërmjet shërbimit mobile të punësimit.

Për të përgatitur stafet dhe rritur kapacitetet përkatëse në nivel qendror dhe lokal, Expertise France ka mbështetur organizimin e seminareve në muajt tetor- nëntor 2023. Gjithashtu, është

mbështetur një vizitë studimore një javore në Francë gjatë muajit nëntor, e cila ka shërbyer më së miri si një mundësi për të shkëmbyer eksperiencë me Shërbimin Kombëtar të Punësimit në Francë dhe për të marrë praktikat më të mira në kuadër të zgjerimit dhe mbulimit të territorit me shërbime të punësimit dhe aftësive.

Realizimi i takimeve rajonale me biznesin

Me mbështetjen e Risi Albania, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes në programet e nxitjes së punësimit, u mbajtën 8 takime rajonale me biznesin. Diskutimi u fokusua se si të mund të rritet ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja në këto programe, veçanërisht në mesin e grupeve të marginalizuara dhe atyre me kualifikime të ulëta. Lidhja me Tregun e Punës, mënyrat se si këto programe mund të ndikojnë pozitivisht në tregun e punës, duke përmirësuar aftësitë dhe mundësitë e punësimit për pjesëmarrësit. Gjatë takimeve u bë një prezantim i detajuar i të gjithë programeve, duke përfshirë qëllimet, target-grupet dhe metodat e zbatimit e përfitimet.

Programi i Punëve Publike në Komunitet ka rezultuar si programi më i suksesshëm për kategorinë e punëkërkuarëve të papunë afatgjatë. Aplikimet më të shumta në këtë program janë nga institucionet shtetërore, ku punësimi pas programit është i vështirë megjithatë ka patur punësime dhe në këto institucione. OJF-të janë të pakta në numër, por aty ku janë bëjnë një punë shumë të mirë sidomos në trajnimin e pjesëmarrësve.

Nga takimet e organizuara me zbatues të programeve dhe pjesëmarrësit në program vihet re se programi ka plotësuar pritshmëritë e tyre, sidomos për kategoritë e veçanta rom/egjiptianë.

Integrimi në tregun e punës i përfituesve të Ndihmës Ekonomike

Në referim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.822, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë pune aktive të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”, dhe të Urdhrit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.52, datë 26.01.2022 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune”, që nga viti 2022 janë krijuar dhe funksionojnë komisionet rajonale tripalëshe në të 12 qarqet, të cilët vlerësojnë dhe referojnë për punësim dhe integrim social anëtarët në moshë aktive të punës nga kjo kategori. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka prioritetizuar dhe trajtuar individualisht të gjithë përfituesit e Ndihmës Ekonomike. Referimi i përfituesve të Ndihmës Ekonomike është kryer përmes Sistemit IT të Shërbimeve të Punësimit.

Zyrat Vendore të Punësimit kanë bërë vlerësimin e individëve të referuar nga SHSSH, me qëllim përputhshmërinë e karakteristikave individuale me alternativat e punësimit, pjesëmarrjen në kurse të formimit profesional apo pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit. Zyrat e punësimit kanë identifikuar edhe individë që kanë pengesa të tjera apo nevoja të shumëfishta si shëndetësore, psiko-sociale etj., të cilat duhet të trajtohen paralelisht me mbështetjen e punësimit dhe i kanë referuar në institucionet përkatëse.

Për vitin 2023, treguesi i integritit në tregun e punës të personave përfitues të Ndihmës Ekonomike ka pasur progres të dukshëm në rritje me rreth 20 % më shumë se një vit më parë.

Konkretisht janë punësuar dhe kanë marrë pjesë në programet e nxitjes së punësimit **3,313 (2820 ndërmjetësime dhe 493 nga programet e nxitjes) punëkërkes të papunë dhe 842 të tjerë** kanë filluar një kurs të formimit profesional.

Zyrat Rajonale	Punësimi nga Ndhma Ekonomike	Formim Profesional	Pjesmarrja në PNP
Berat	93	23	16
Diber	247	117	62
Durres	58	9	0
Elbasan	483	105	78
Fier	159	46	51
Gjirokaster	71	4	14
Korce	249	92	51
Kukes	317	89	16
Lezhe	138	89	4
Shkoder	158	83	8
Tirane	644	70	174
Vlore	203	115	19
Grand Total	2820	842	493

Trajtimi i personave PAK dhe operacionalizimi i Fondit Social

Në kuadër të rritjes së integritimit në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e Nxitjes, që lidhen me përcaktimin e organit publik përgjegjës (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), për mbledhjen e detyrimeve, është mundësuar që në vijim Fondi Social i Punësimit të bëhet i zbatueshëm.

AKPA ka realizuar një plan konkret të masave, që duhen ndërmarrë lidhur me instrumentat, paketën rregullatore të nevojshme për zbatim, si dhe aktivitetet promovues për aktivizimin e Fondit Social.

AKPA gjatë vitit 2023 ka realizuar analizën e situatës aktuale në Shqipëri mbi punësueshmërinë e PAK, duke vlerësuar numrin e subjekteve publike dhe private që sipas përcaktimit ligjor kanë detyrimin për punësimin e tyre apo derdhjen e kontributit si dhe numrin e personave PAK që duhet të punësohen. Gjithashtu AKPA në bashkëpunim me MFE ka nisur serinë e takimeve informuese me bizneset mbi angazhimin e tyre në zbatimin e ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuar. U zhvilluan 5 takime me punëdhënës të sektorëve më të ndikuar nga zbatimi i këtij përcaktimi ligjor: si Sektori Financiar, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, Sektori i Tregtisë, Sektori i Ndërtimit dhe Sektori i Hoteleri Turizmit.

Me fokus vënien të funksion të Fondit Social në Shqipëri, u ndërmor regjistrimi i punëkërkesve me aftësi të kufizuar si një garanci për punëdhënësit të cilët kanë detyrimin e punësimit të tyre. Janë regjistruar mbi 8,000 persona PAK (pjesa më e madhe të regjistruar si punëkërkes dhe jo si punëkërkes të papunë) në databazën e sistemit të shërbimeve të punësimit.

Gjithashtu, është realizuar procesi i përcaktimit të Kornizës së Standardeve Fizike që Zyrat e Punësimit duhet të kenë për të siguruar aksesueshmëri të shërbimeve të punësimit për personat me Aftësi të Kufizuar. Në këtë kontekst, Zyra e Punësimit Tiranë (zona 2), është rikonstruktuar dhe përshtatur me pajisje teknologjike të dedikuara për ofrimin e shërbimeve të punësimit sipas nevojave specifike të këtyre kategorive.

Përmes këtij investimi bëhet i mundur akses i më i madh i këtij grupi në shërbimet e punësimit të targetuara dhe përshtatura me qëllim integrimin më të shpejtë në tregun e punës.

Analizat e Tregut të Punës

Gjatë vitit 2023, AKPA ka vijuar të ndërmarrë një sërë veprimtarish që lidhen me analizimin e tendencave të tregut të punës dhe politikave të zbatuara për punësimin dhe aftësimin profesional.

Hartimi dhe publikimi i Buletinit Statistikor Vjetor për vitin 2022

Në faqen zyrtare të AKPA është publikuar Buletini Statistikor, i cili është një dokument i përvitshëm dhe thelbësor për pasqyrimin dhe analizimin e tendencave të tregut të punës [BULETINI-STATISTIKOR-2022.pdf \(akpa.gov.al\)](https://akpa.gov.al/BULETINI-STATISTIKOR-2022.pdf). Ky publikim prezanton për vendimmarrësit, administratorët, komunitetin e biznesit, studiuesit dhe të gjithë përdoruesit e statistikave të dhëna të detajuara për tregun e punës për vitin 2022.

Statistikat e tregut të punës që siguron dhe publikon Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive japin një përshkrim të strukturës së tregut të punës bazuar në informacionin periodik të të dhënave administrative si dhe rezultatet kryesore të politikave shtetërore të punësimit si rregullatorë në këtë treg.

Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të tregut të punës është sigurimi i një informacioni sa më të plotë mbi tregun dhe dinamikën e tij, si dhe për të vënë në dispozicion të politikbërësve statistikave të duhura për hartimin e politikave të punësimit.

Të dhënat për punësimin, papunësinë, arsimin dhe formimin profesional që publikohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), bazohen në burimet administrative dhe i referohen kryesisht:

1. Punëkërkesve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
2. Punëdhënësve të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
3. Shërbimet që Zyrat e Punësimit ju ofrojnë punëkërkesve dhe punëdhënësve;
4. Kursantët që ndjekin kurset e formimit profesional pranë DROFPP-ve;
5. Nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm profesional publik.

Analizat rajonale në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së programeve të AFP me kërkesat e tregut

Në kuadër të planifikimit afatmesëm të AFP, gjatë 3 mujorit të parë 2023 DPITP dhe DMOAFP përgatitën katër Analizat Rajonale të tregut të punës për rajonin verior, rajonin juglindor; rajonin jugperëndimor dhe rajonin qendror.

Analizat morën në konsideratë numrin e VLP-ve të shpallura në sistemin e shërbimeve të punësimit sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale si dhe numrin e nxënësve dhe kursantëve në VET të zbërthyer sipas profesioneve për secilën nga 9 kategoritë profesionale.

Rezultatet e përputhjes së kërkesës (VLP) dhe ofertës së AFP sipas profesioneve u kryqëzuan dhe nivelet e punësueshmërisë së kurseve/drejtimeve të shkollave/programeve të nxitjes së punësimit të dala nga rezultatet e gjurmimeve. Analiza u fokusua në identifikimin e mospërputhjeve dhe nxjerrjen e rekomandimeve për incentivimin/hapjen e programeve efektive dhe dekurajimin e programeve që nuk kanë relevancë me nevojat vendase të tregut të punës.

Analiza vjetore mbi ecurinë e aktiviteteve për vitin 2023, që i përgjigjen arritjes së objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030

Analiza përmban të dhëna të strukturuar mbi rezultatet e politikave dhe programeve të punësimit e aftësisimit si dhe veprimtarinë institucionale të AKPA. Ajo shërben si një mjet paraprak për pasqyrimin e statistikave vjetore dhe evidentimin e zhvillimeve cilësore të institucionit, në përputhje me orientimet e dokumentit strategjik të punësimit dhe aftësive.

Kapitulli IV

FUQIZIMI INSTITUCIONAL



KAPITULLI IV- FUQIZIMI INSTITUCIONAL

Ristrukturimi i AKPA-s dhe institucioneve të varësisë

Më datë 05.10.2023 hyri në fuqi Urdhri i Kryeministrit nr. 164, datë 05.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Menjëherë filloi procesi i ristrukturimit për Drejtorinë Qendrore të AKPA-s dhe DRAKPA. Më datë 22.11.2023 përfundoi procesi i ristrukturimit për Drejtorinë Qendrore të AKPA-s ndërsa për Drejtoritë Rajonale të AKPA-s procesi ende nuk është finalizuar.

Në të njëjtën kohë janë kryer procedurat për riorganizimin e institucioneve arsimore në qarqet e Durrës, Elbasan dhe Korçë, në kuadër të procesit optimizimit.

Më hyrjen në fuqi të Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.10168/1, datë 05.06.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikave të Qendrave të Formimit Profesional Publik“, i ndryshuar, përfunduan procedurat e ristrukturimit për 10 Qendrat e Formimit Profesional Publik.

Plani i Integritetit

Në kuadër të Vendimit nr. 247, datë 20.03.2015, të Këshillimit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023”, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve, si dhe kërkesës së MFE-s, nga ana e Sektorit Juridik në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të Drejtorisë Qendrore është hartuar Plani i Integriteti

Planifikimi dhe instrumentet e monitorimit të brendshëm institucional

Me qëllim monitorimin dhe sigurimin e përmbushjes së objektivave AKPA ka ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Ka realizuar hartimin e Planit të Objektivave Institucional për vitin 2023, si dhe ka monitoruar në mënyrë periodike realizimin e tij;
- Ka finalizuar shpërndarjen e fondeve dhe përcaktimin e numrit të pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit për vitin 2023;
- Ka realizuar analizën dhe raportimin drejt MFE mbi ecurinë dhe progresin e realizimit të objektivave të Strategjisë për vitin 2022;
- Ka realizuar raportimin periodik dhe bashkëpërgatitur prezantimet në kuadër të proceseve negociuese me BE, dhe më konkretisht mbi Kapitullin 2, Kapitullin 19, Komitetin e Inovacionit dhe kapitujve të tjerë ku AKPA kontribuon si 18, 23, 26;
- Në zbatim të rregulloreve përkatëse të programeve të nxitjes u realizua procesi i gjurmimit për të gjithë pjesëmarrësit e programeve të nxitjes së punësimit të cilët i nisën programet në vitin 2021 dhe për grupin e kontrollit përkatës;
- Gjatë vitit 2023 është vijuar me dhënien e kontributit për raportimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021- 2030, Startegjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për

- të mitur 2022- 2026, Planit Kombëtar të Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje e romëve/ egjiptianëve 2021-2025, Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI 2021-2027, Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023; Planit Kombëtar të Veprimit mbi moshimin 2020-2024, draft Strategjisë së Migracionit 2024-2026 dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.
- Ka realizuar raportimin vjetor në sistemin Romalb mbi realizimin e indikatorëve të AKPA në Planin Kombëtar të veprimit për Rom/Egjiptianët 2021- 2025. Raportimi i indikatorëve u realizua në nivel qendror (raportimi i AKPA Qendrore) dhe rajonal (raport për çdo DRAKPA).
- Ka realizuar raportimin në INSTAT të statistikave të mbrojtjes sociale sipas formatit të ESPROSS për vitet 2021-2022.dhe statistikat e 3 mujorit të parë të vitit 2023.

Karta e Performancës dhe Treguesit e Monitorueshëm

Treguesit e Monitorueshëm për Drejtoritë Rajonale të AKPA

Karta e treguesve të monitorueshëm për zyrat e punësimit përcakton arritjet vjetore të indikatorëve më të rëndësishëm që masin nivelin e shërbimit të Zyrës së Punës ndaj klientëve të saj: punëkërkuesit dhe punëdhënësit. Treguesit kryesor të performancës si punësimet, përfshirja në programet aktive të tregut të punës, numri i VLP-ve (postimeve) të shpallura dhe rritja e numrit të punëdhënësve klientë të Zyrës së Punës, detajohen edhe në tregues të tjerë që i referohen priorizimit të grupeve vulnerabël në zbatim të treguesve të strategjive përkatëse dhe indikatorëve të tjerë strategjik. Treguesit e monitorueshëm për vitin 2023 janë përcaktuar duke marrë në konsideratë gjithë aktivitetet e nevojshme që Zyrat e Punësimit duhet të ndjekin, indikatorët e përcaktuar në dokumenta strategjik, realizimin e treguesve të vitit 2022, fondet në dispozicion për zbatimin e PATP-ve ekzistuese dhe të reja gjatë 2023 si dhe kontekstin lokal.

Gjatë muajit Janar 2023, u finalizua përcaktimi dhe shpërndarja e treguesve të monitorueshëm për zyrat e punësimit në nivel vjetor.

Treguesit e Monitorueshëm për DROFPP-të

Në vijim të finalizimit të treguesve të monitorueshëm të zyrave të punësimit, përfundoi përcaktimi dhe shpërndarja e treguesve të monitorueshëm për DROFPP-të. Seti i indikatorëve që përmban kjo kartë ndërthuret me Kartën e Treguesve të Monitorueshëm të Zyrave të Punës, duke unifikuar objektivat e përbashkët të cilët përbëjnë rreth 53% të pikëve në kartën e DROFPP-ve.

Kjo shpërndarje u realizua në nivel vjetor dhe 6 mujor. Me qëllim realizimin e indikatorit të kontratës së mbështetjes buxhetore “BE për Përfshirjen Sociale”, për pjesëmarrjen në PATP të rreth 14,704 pu.pa-ve deri në muajin Qershor 2023, u vendos që rreth 56% e pu.pa të ndiqnin kurset e formimit brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023. Për shpërndarjen e treguesve të secilës DROFPP u mor në konsideratë mbulimi i zyrave të punës.

Treguesit e Monitorueshëm për Arsimin Profesional

Gjatë muajit mars 2023 përfundoi përcaktimi dhe shpërndarja e treguesve të monitorueshëm për shkollat e mesme të arsimit profesional. Kjo shpërndarje u realizua në nivel vjetor. Në kartën e performancës së shkollave janë vendosur indikatorë që lidhen me gjurmimin, regjistrimet në vitin e ri shkollor, cilësinë e mësimdhënies dhe rezultatet e nxënësve.

Monitorimi i ecurisë së realizimit të indikatorëve të “Budget Support 2023”

Në kontratën “BE për Përfshirjen Sociale”, AKPA është institucion përgjegjës / bashkëpërgjegjës për 6 indikatorë prej të cilëve 4 indikatorë janë të lidhur direkt me përfitime financare për buxhetin e shtetit. Këta indikatorë janë:

- % e të diplomuarve në AFP të punësuar;
- ***Numri i Pu.Pa- ve të cilët janë pjesëmarrës në PNP dhe kurset e formimit profesional;***
- ***Përqindje të punëkërkuësve të papunë të regjistruar ne raport me LFS;***
- ***Stoku vjetor i të rinjve PAFP si punëkërkuës të papunë;***
- ***Procesi i optimizimit (Përgjegjësi e MFE);***
- Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me bashkitë.

Gjatë 6 muajit të parë të vitit 2023 është kryer monitorimi i ecurisë së këtij treguesi me periodicitet mujor dhe është raportuar realizimi i indikatorëve që lidhen me disbursimin e kështit të dytë. AKPA ka realizuar në masën **100%** indikatorët e vendosur.

Hartimi i Programit të ri Statistikor të AKPA

Në kuadër të zbatimit të funksioneve, monitorimit të tyre si edhe nisjes së funksionimit të SSHP të përmirësuar, gjatë vitit 2023 Programi Statistikor i AKPA, u rishikua dhe përmirësua.

Programi i ri Statistikor i AKPA përbëhet nga 7 kapituj si: Oferta për punë; Kërkesa për punë; Shërbimet dhe programet e Zyrave të Punës; Formimi Profesional; Arsimi Profesional; Burimet njerëzore; Projektet dhe komunikimi.

Me përjashtim të kapitujve 1-3, të cilët u pasuruan për shkak të rritjes së numrit të shërbimeve që agjencia ofron, kapitujt e tjerë janë evidenca të hartuara dhe përfshira për herë të parë në program si rrjedhojë e funksioneve të reja që iu caktuan AKPA-s.

Kapacitimi i burimeve njerëzore dhe fuqizimi i instrumentave për certifikimin e AKPA-s si institucion prodhues i statistikave zyrtare (Eurostat)

Gjatë muajit tetor në kuadër të projektit RCC-ESAP 2 “Udhërrëfyeni për harmonizimin e bazave të të dhënave për politikat e tregut të punës të Ballkanit Perëndimor me BE-në dhe ndërtimin e

kapaciteteve për partnerët nga Ballkani Perëndimor”, stafi i SITP mori pjesë në trajnimin që synonte identifikimin e të gjitha politikave të tregut të punës, si dhe formatin e raportimit të këtyre të dhënave për përfituesit dhe kostot, në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it.

Gjithashtu janë planifikuar takime bilaterale me INSTAT si institucioni lider në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare, për të ndjekur pjesën e metodologjisë së të dhënave dhe ndarjen e detyrave mes dy institucioneve për statistikat e tregut të punës.

Gjurmimi i përfituesve të Programeve të Nxitjes së Punësimit

Gjatë muajit Janar përfundoi hartimi i raportit të gjurmimit për pjesëmarrësit në programet e nxitjes së punësimit në 2020.

Në bashkëpunim me Sektorin e Programeve Aktive dhe Pasive të Tregut të Punës, gjatë muajit prill 2023 u rishikua dhe përmirësua formati i databazës së gjurmimit të pjesëmarrësve në PNP.

Pas dakordësimit formati i databazës me udhëzuesin përkatës iu dërgua të gjithë DRAKPA-ve për nisjen e procesit të gjurmimit të pjesëmarrësve në vitin 2021.

Faza e anketimit/gjurmimit nisi në muajin prill dhe përfundoi në muajin korrik. Sektorët që realizuan këtë fazë ishin Sektori i Programeve Aktive dhe Pasive si edhe ZVAKPA-t në çdo rajon. Databaza me rezultatet e gjurmimit u dërgua në AKPA Qendrore për të vijuar me procesin e validimit dhe analizimit të të dhënave. Hartimi i raportit pritet të finalizohet në shkurt 2024.

Kapitulli V

TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN



KAPITULLI V- TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, ka hartuar një plan komunikimi që ka si qëllim informimin e grupeve të interesit dhe publikun e gjerë. I është kushtuar një vëmendje e veçantë promovimit të Agjencisë përmes përcjelljes së informacionit nëpërmjet kanaleve të komunikimit, mbi politikën, nismat, dhe aktivitetet e ndërmarra prej saj.

Panairi i Punës dhe i Aftësive 2022



Panairi i Punës dhe i Aftësive është një prej aktiviteteve kyçe që Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive realizoi gjatë vitit 2023. Nëpërmjet panairit mundësohet që punëdhënësit të takojnë dhe të intervistojnë kandidatët potencialë për punë si dhe të identifikohet një numër më i madh ofertash për punësim. Panairi i Punës dhe Aftësive qëndron gjithashtu si një aktivitet i cili rrit ndjeshëm dukshmërinë e Agjencisë dhe shërbimeve që ajo ofron. Ai në të njëjtën kohë ndikon te klientët e agjencisë në forcimin e besimit ndaj institucionit.

Në Panairin e Punës dhe Aftësive 2023, të zhvilluar gjatë datave 24-26 prill 2023, morën pjesë rreth 10 mijë pjesëmarrës dhe vizitorë. Panairi ofroi për pjesëmarrësit:

- 4 Panele proaktive të Forumit të Klimës së Biznesit, ku u diskutua rreth ndikimit të politikave ekonomike dhe legjislacionit aktual në klimën e biznesit dhe nxitjen e investimeve private.

- Rreth 1200 oferta aktive punësimi nga biznese lokale dhe ndërkombëtare.

- Mundësi të shumëfishta të Arsimit dhe Formimit Profesional nga 29 institucione arsimore dhe trajnimi.

Publikimi i Vendeve të Lira të Punës dhe Sigurimi i Informacionit

Gjatë vitit 2023 nga ana e subjekteve janë shpallur 61,173 vende të lira pune ose rreth +54% më shumë se një vit më parë. Në të njëjtën kohë gjatë këtij viti janë publikuar nga AKPA dhe 2,327 vende të lira pune të shpallura nga Administrata Publike. Përveç publikimeve për Administratën Publike, AKPA shpall dhe vendet e lira të punës për të gjitha zyrat e varësisë së saj, përfshirë këtu Zyrat e Punësimit, Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik dhe Shkollat e Mesme Profesionale.

Promovimi i Rasteve të Suksesit

AKPA, sa i përket angazhimit në fushatat promovuese, ka në fokus evidentimin dhe promovimin e rasteve të suksesit të punëkërkesve të papunë që integrohen në tregun e punës. Gjithashtu, në kuadër të promovimit të rëndësisë dhe mundësive të ofruara nga sistemi i AFP-së, janë publikuar në mënyrë të vazhdueshme raste suksesi ose dëshmi personale nga nxënës në Arsim Profesional, ose kursant në Formim Profesional.

Gjatë vitit 2023, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e imazhit të AFP-së, janë zhvilluar aktivitetet sa më poshtë vijon:

1. Realizimi i videove promovuese për shkollat e mesme profesionale në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor dhe praktikave profesionale.
2. Promovimi i 52 rasteve të suksesshme të nxënësve që studiojnë në shkollat profesionale.
3. Realizimi i 59 videove për promovimin e rasteve të suksesit të ndërmjetësuar nga ana e Zyra të Punës apo punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.
4. Janë përgatitur rreth 62 infografe/video të tjera për promovimin e shërbimeve dhe programeve të punësimit në zyrat e punës dhe rrjetit të ofruesve të AFP-së.
5. Prej videove dhe infografeve të realizuara, 17 prej tyre kanë qenë të dedikuara për programin e kodimit, si një ndër politikat më efikase të ndërmarra së fundmi nga AKPA.
6. Janë realizuar rreth 25 dalje mediatike të përfaqësuesve të institucionit, për të dhënë informacion mbi tendencat e tregut të punës dhe politikat/programet e zbatuara.

Menaxhimi i Sistemit të Kërkesave për Informacion dhe i Ankesave

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka vendosur në dispozicion të qytetarëve disa kanale komunikimi përmes të cilave mund të informojë dhe adresojë të gjitha kërkesat dhe ankesat në fushën e punësimit dhe aftësimit profesional. Administrimi i tyre kryhet përmes një databaze manuale, në të cilën mbahen rekordet e çdo anese në drejtim të AKPA nga të gjitha kanalet e komunikimit.

Kërkesa për informacion

Gjatë vitit 2023 AKPA ka pasur 20 raste “Kërkesa për informacion” të cilat janë trajtuar në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Kryesisht ato kanë kërkuar informacion mbi statistikën dhe të dhënat e tregut të punës dhe janë trajtuar nga Sektori i Informacionit të Tregut të Punës duke respektuar afatet e përcaktuara sipas ligjit. Këto kërkesa janë pasqyruar në Regjistrin e kërkesave për informacion sipas formatit të kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për periudhën janar-dhjetor në adresën kontakt@akpa.gov.al kanë ardhur dhe 1421 kërkesa apo ankesa të tjera të cilat janë deleguar dhe dhënë përgjigje brenda afateve.

Në llojin e kërkesave ato që lidhen me punësimin janë më të shumtat. Kërkesat kryesisht janë për informacion mbi aplikimet për leje unike për shtetas të huaj, për informacion mbi kurset e formimit profesional dhe aplikim në kurset e programit të kodimit, për informacion për të përfituar nga programet e Nxitjes së Punësimit si dhe për vërtetimet si punëkërkues i papunë apo pagesë papunësie.

Kërkesa të ardhura nëpërmjet rrjeteve sociale

Nga adresa zyrtare e Facebook të AKPA janë regjistruar 143 kërkesa. Të gjitha kërkesat e orientuara në faqen zyrtare FB, u trajtuan dhe qytetarët morën morën informacion dhe shpjegim të detajuar brenda 48 orëve.

Nga adresa zyrtare në Instagram janë regjistruar rreth 110 kërkesa. Të gjitha kërkesat e ardhura janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje brenda afateve.

Kërkesa të ardhura nga telefoni

Nga numri i telefonit i AKPA i vënë në dispozicion të qytetarëve, gjatë vitit janë regjistruar rreth 760 telefonata. Qytetarët marrin informacion dhe kërkesat e tyre delegohen në kohë reale në varësi të rëndësisë dhe problematikave.

Platforma e Bashkëqeverisjes

Nga Platforma e Bashkëqeverisjes për periudhën janar-dhjetor 2023 janë regjistruar 116 çështje apo ankesa. Konkretisht, janë trajtuar 47 çështje të lidhura me kërkesat për punësim, ku kryesisht kërkohet punë në institucione shtetërore. Institucioni ka bërë të mundur ndërmjetësimin e një pjese prej tyre në sektorin privat. Gjithashtu, 28 raste janë trajtuar për pagesë papunësie dhe 9 ankesa i referohen Qendrave të Formimit Profesional. Të gjitha rastet u trajtuan dhe ezauruan brenda një afati 10 ditor.

Kapitulli VI

BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT SOCIAL, PROJEKTET DHE DONATORËT



KAPITULLI VI- BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT SOCIAL, PROJEKTET DHE DONATORËT

Forcimi i Bashkëpunimit me Partnerët Social

Përgjatë vitit 2023, AKPA ka lidhur 4 marrëveshje bashkëpunimi, përkatësisht me:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me Swisscontact me projektin “Perspektiva të Reja”. Kjo marrëveshje ka këto objektiva kryesorë:
 - Trajnimin e këshilluesve (nga Projekti) për punëkërkesit nga Drejtoria Rajonale e Punësimit në Kukës me asistencë të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA-s, për të vene në praktikë modelin e ri të këshillimit, bazuar në qasjen C4EE,
 - Mbështetjen për nxitjen e punësimit, më konkretisht me zhvillimin e programit të Kodimit në Qarkun e Kukësit, duke ofruar mbështetje dhe bursa për aplikantët që plotësojnë kriteret apo promovimin e këtij programi përmes kanaleve të komunikimit të projektit.
2. Memorandum bashkëpunimi me Auto City sh.a. Në fokus të këtij memorandum me qëllim bashkëpunimin mes palëve për pjesëmarrjen e shkollave profesionale në evente të organizuara nga Auto City, konkretisht:
 - Turism Expo, i cili u zhvillua më 8 Prill 2023
 - Food & Drink Expo, i cili u zhvillua në datat 23-25 Maj 2023
3. Marrëveshje bashkëpunimi me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), me objektiv:

Bashkëpunimin e ndërsjelltë institucional për zbatimin e projektit të përbashkët “Sunny Schools scaling up-first phase”, me qëllim investimin në instalimin e një impianti fotovoltaik (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesat e dy shkollave profesionale: “Gjergj Canco” në Tiranë dhe “Ali Myftiu” në Elbasan.
4. Memorandum bashkëpunimi me Programin Reconomy, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Qëllimi i këtij Memorandum Mirëkuptimi është të vendosë termat dhe kushtet e bashkëpunimit ndërmjet AKPA dhe Programit RECONOMY për të arritur objektivin e rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të shërbimeve të zyrave të punësimit duke përmirësuar/digjitalizuar më tej shërbimet e tyre.

Projektet dhe bashkëpunëtorët



Projekti DORE (Banka Botërore)

DORE është një projekt i propozuar nga Banka Botërore i cili synon të mbështesë përmirësimin e punësueshmërisë së grupeve vulnerabël dhe performancën e sistemit të ndihmës sociale. Ky projekt perbehet nga 3 komponentë:

- Komponenti 1, fokusohet në rritjen e punësueshmërisë së përfituesve të ndihmës sociale dhe mbështetjen e kalimit të tyre në tregun e punës;
- Komponenti 2, në përmirësimin e performancës së sistemit të asistencës sociale;
- Komponenti 3, korrespondon me mbështetjen e zbatimit.

Gjatë muajit shkurt përfaqësues të BB dhe AKPA zhvilluan takime dhe diskutime të shumta me qëllim dakordësimin dhe finalizimin e aktiviteteve dhe indikatorëve që përmban Draft Komponenti i parë i DORE.



UNDP Albania

Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes shumëvjeçare të UNDP Albania, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka realizuar disa aktivitete si:

- Finalizimi i Strategjisë për Punësim dhe Aftësi 2023- 2030, nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Draftimi i Programit të Ri të Nxitjes së Punësimit nëpërmjet Riintegritit Social.
- Kontribut në realizimin e Panairit të Punës dhe Aftësive 2023 dhe Formimit të Klimës së Biznesit.

Skills Development for Employment Programme (SD4E), në bashkëpunim me projektin “Skills for Jobs” me financimin e Qeverisë Zviceriane, kanë hyrë në fazën EXIT të projekteve përkatëse. Kjo fazë synon sigurimin e vazhdimësisë së ndërhyrjeve dhe produkteve të realizuara nga projektet me kapacitetet e vetë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si në fushën e punësimit ashtu dhe atë të aftësive.



Fondi Rajonal i Sfidave- KFW

Regional Challenge Fund (RCF), është një instrument i Bankës Gjermane për Zhvillim (KFW), i cili mbështet projekte që implementohen bashkërisht nga institutet e aftësimit profesional dhe sipërmarrjet partnere që angazhohen ose planifikojnë të angazhohen, në aktivitete të trajnimit bashkëpunues, për të krijuar dhe rritur punësueshmërinë, veçanërisht tek të rinjtë.

Me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në thirrjen e tretë për propozime të hapur gjatë vitit 2023, aplikuan 23 ofrues të Arsimit dhe Formimit Profesional Publik.

Në fillim të vitit 2024, pritet të shpallen dhe shkollat fituese të fazës finale të vlerësimit të thirrjes së tretë për propozime.



SWISSCONTACT ALBANIA

Swisscontact Shqipëri është një prej partnerëve kyç të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive i cili përgjatë vitit 2023 ka mbështetur institucionin nëpërmjet projekteve:



BOOST EMPLOYMENT- Me suportin e projektit, AKPA ka dizenuar instrumentin e Planit Individual të Punësimit të përmirësuar në Sistemin Informatik të shërbimeve të Punësimit. Më qëllim kryesor rritjen e kapaciteteve të stafit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve të punësimit, gjatë vitit 2023 janë zhvilluar trajnimet për të gjithë punonjësit e rinj (60 punonjës) të Drejtorive Rajonale të Punësimit në dy vitet e fundit. Në fund të trajnimit punonjësit iu nënshtruan një testi për konceptet bazë të shërbimeve. Për këto trajnime u hartuan paketa të mirëfillta, të cilat do të shërbejnë edhe për trajnime të tjera.



“PERSPEKTIVA TË REJA” është një projekt socio-ekonomik dhe zhvillimor që zbatohet në Qarkun e Kukësit nga Swisscontact dhe financohet nga Mbretëria e Bashkuar. Projekti “Perspektiva të reja” është një projekt, i cili synon zhvillimin e punësimit, sipërmarrjes dhe mundësive për biznes në qarkun e Kukësit (Bashkitë Kukës, Has dhe Tropojë). Në kuadër të këtij projekti, vijon të kryhet trajnimi i këshilluesve për integrimin e punëkërkuësve nga 3 nivelet e punësueshmërisë drejt (vetë)punësimit në Qarkun Kukës bazuar në qasjen C4EE (Coaching for employment and entrepreneurship). Gjatë vitit të parë të zbatimit të projektit janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Janë trajnuar me metodologjinë C4EE mbi këshillimin drejt punësimit dhe sipërmarrjes, 7 punonjës në 4 Zyra Punësimi. Respektivisht: 2 nga Zyrën e Punës Kukës, 1 në Zyrën e

Punës Has, 2 në Zyrën e Punës Tropojë dhe 2 në Zyrën e Punës Dibër. Deri tani janë zhvilluar dy blloqe trajnimi;

- Bashkëpunim dhe mbështetje e zhvillimit të panairit work&study të zhvilluar në muajin qershor 2023;
- Është realizuar promovimi i programit të kodimit në rrjetet sociale dhe informimi në komunitet. Në AKPA Dibër janë bërë përpjekjet për ngritjen e një grupi të ri që do të mbështetet nga projekti.



IPA Instrument for Pre-accession Assistance III

Në kuadër të Instrumentit për Mbështetjen e Para-anëtarësimit, me koordinimin e MFE-së, AKPA ka ndjekur dhe punuar intensivisht me Mbështetjen Teknike për procesin e përgatitjes së paketës së Programimit dhe të Mirëbesimit të Programit Operacional të IPA III “BE për Punësimin e të Rinjve”. Plani Operacional i Garancisë Rinore u dorëzua zyrtarisht në Komisionin Evropian në muajin qershor. Do të vijohet me përgatitjen e paketës së mirëbesimit për përmbylljen e procesit.



Aleanca Franceze për Zhvillim

Në mars 2023, AKPA ka nisur ciklin e takimeve me Aleancën Franceze për Zhvillim, me qëllim zbatimin e Programit të Asistencës Teknike (AT) të ofruar nga Expertise France (EF), i cili synon të mbështesë përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të zbatuar veprimet prioritare të Matricës së Politikave, dhe në përgjithësi për të rritur barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në ekonomi.



Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO)

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, AKPA ka nisur procesin e bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO) për mbështetjen e MFE-së në integrimin e iniciativave të Garancisë Rinore dhe përgatitjen e “Strategjisë së kontaktit për të rinjtë shqiptarë NEET”.

Në vijim të bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare të Punës, në kuadër të fuqizimit të Dialogut Social, AKPA ka trajnuar për herë të parë 12 ndërmjetësues fillestar të konflikteve në Zyrat e Punës, si dhe janë certifikuar 11 punonjës të AKPA qendrore dhe rajonale si Pajtuës të Konfliktëve.



GIZ Albania

Në kuadër të projektit “Dizenjimi i protokollit të shërbimeve për migrantët e kthyer”, si dhe zhvillimit të aktiviteteve dhe masave për ngritjen e kapaciteteve për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, me mbështetjen e GIZ Albania, po punohet për ndërtimin e web-faqes dedikuar migrantëve të kthyer. Në këtë kuadër, GIZ po mbështet Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për kryerjen e një analize nevojash për trajnim lidhur me ofrimin e shërbimeve të punësimit ndaj migrantëve të kthyer me qëllim ngritjen e kapaciteteve të stafit të Agjencisë dhe zyrave vendore të punësimit, në veçanti për trajnimin e këtij target grupi. Ndër të tjera, GIZ Albania ka mbështetur AKPA-n për realizimin e Panairit të Punës dhe Aftësive 2023.



RISI ALBANIA

Me mbështetjen e RISI Albania, gjatë vitit 2023, AKPA ka realizuar një sërë aktivitete promovuese për forcimin e bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat në sektorin e punësimit të denjë. Në këtë kuadër, AKPA ka realizuar 3 takime rajonale me punëdhënësit, përfaqësues të biznesit dhe partnerë të tjerë social me qëllim promovimin e shërbimeve dhe programeve të punësimit që Agjencia ofron. Këto takime shërbyen gjithashtu si platforma komunikimi për forcimin e bashkëpunimit mes sektorëve për një funksionim më cilësor të tregut kombëtar të punës.

Në vijim të këtyre takimeve, me qëllim promovimin e Garancisë Rinore dhe Programeve Aktive të Tregut të Punës u zhvilluan 2 webinarë me pjesëmarrjen e mbi 100 punëdhënësve.

Në dhjetor të 2023, me mbështetjen e Risi Albania, u zhvillua event i dedikuar Punësimit të Denjë. Ky event u cilësua si një platformë shkëmbimi, i cili mbledhi së bashku bizneset, sektorin publik, komunitetin ndërkombëtar të zhvillimit dhe akademinë për të zbërthyer këtë çështje në Shqipëri, me fokus në elementët e punës së denjë.



RECONOMY

RECONOMY është një program zhvillimi ekonomik gjithëpërfshirës dhe i gjelbër i iniciuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida) dhe zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Ajo operon në rajonet e Partneritetit Lindor dhe Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë 11 vende, përfshirë Shqipërinë. Objektivi kryesor i RECONOMY është të lehtësojë krijimin e mundësive ekonomike për gratë dhe të rinjtë, veçanërisht ata që janë të pafavorizuar dhe të marginalizuar, duke rritur të ardhurat e tyre dhe duke promovuar punësim të denjë dhe miqësor ndaj mjedisit në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

RECONOMY zbaton projekte të ndryshme në Ballkanin Perëndimor. Midis tyre, Projekti i “Zbatimit të Politikave të Tregut të Punës dhe Punësimit” (LMPIE) fokusohet në përmirësimin e

menaxhimit të burimeve njerëzore dhe modernizimin e shërbimeve publike brenda institucioneve përkatëse publike në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Ky projekt mbështet trajnimin e nëpunësve civilë për rolet e tyre, përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe zbatimin e shërbimeve elektronike në autoritetet publike. Për më tepër, projekti synon të përmirësojë Sistemet e Informacionit të Tregut të Punës (LMIS), duke mundësuar akses më të lehtë në shërbime përmes mjeteve digjitale. Një aspekt tjetër kyç i projektit është forcimi i funksionit të trajnimit brenda Shërbimeve Publike të Punësimit (SHPP) për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional, transferim të njohurive dhe profesionalizëm midis e stafit. Në këtë përpjekje, AKPA shërben si një nga partnerët strategjikë që punon drejt arritjes së objektivave të projektit.

Në kuadër të projektit, me mbështetjen e projektit AKPA synon të:

- I. Përmirësojë ofrimin e informacionit të përshtatshëm dhe në kohë për të rinjtë, gratë dhe grupet më të pafavorizuara në lidhje me mundësitë e punësimit dhe/ose përmirësimin e mëtejshëm dhe rikualifikimin, angazhimin në një bashkëpunim kuptimplotë me sektorin privat.
- II. Forcojë kapacitetet institucionale dhe të modernizohet më tej për të rritur efikasitetin dhe kapacitetin për të ofruar shërbime cilësore.
- III. Ngrejë dhe përmirësojë instrumentet për analizimin e tregut të punës.
- IV. Sigurojë mbështetje teknike në bashkëpunim me “Arbetsförmedlingen” Agjencinë Suedeze të Punësimit lidhur me metodat e bashkëpunimit mes aktorëve të tregut të punës për ofrimin e shërbimeve të punësimit, si dhe përgatitjen institucionale të përdorimit efektiv të fondeve të strukturuar.



mundësi

aftësi

punësim

puna.gov.al

ANALIZA VJETORE
AKPA 2023